



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Ngarkesa me Borxh e Ekonomive Familjare në Kosovë

Krenare MALOKU BAKIJA dhe Arta NUSHI

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# **Ngarkesa me borxh e ekonomive familjare në Kosovë**

Mars 2022

**BOTUES**

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar  
33 Garibaldi, Prishtinë 10 000  
Tel: ++381 38 222 055  
Fax: ++381 38 243 763

**Faqja e internetit**

[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**Adresa elektronike**

[economic.analysis@bqk-kos.org](mailto:economic.analysis@bqk-kos.org)

**REDAKTOR**

**Zana GJOCAJ**

**AUTORË**

**Krenare MALOKU BAKIJA**  
**Arta NUSHI**

**Falenderimet:**

Falenderime të veçanta iu drejtohen ekipit të Regjistrimit të Kredive të Kosovës (RKK) si dhe përfaqësuesve të Institucioneve Financiare pjesëmarrëse në studim, për kontributin e tyre të çmueshëm në procesin e mbledhjes së të dhënave.

**Vërejtje:**

Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.  
Citimi i sugjeruar: Maloku Bakija, K. & Nushi, A. (2022), Ngarkesa me borxh e ekonomive familjare në Kosovë, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.  
Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.

## PËRMBAJTJA:

1. HYRJE -----	7
2. Përmbledhje e rezultateve-----	8
3. Metodologjia e studimit-----	12
3.1. Burimi i të dhënave-----	12
3.2. Mostra e studimit -----	13
3.3. Kufizimet e të dhënave të shfrytëzuara -----	14
3.4. Përkufizimi i ngarkesës me borxh -----	17
3.5. Përpunimi i të dhënave-----	20
4. Rezultatet-----	21
4.1. Karakteristikat socio-demografike dhe socio-ekonomike të huamarrësve-----	21
4.2. Modelet e huamarrjes -----	25
4.3. Performanca në shlyerjen e borxheve-----	39
4.4. Niveli i ngarkesës me borxh -----	46
5. Përfundim -----	60
5.1. Kufizimet e Studimit-----	61
6. Rekomandime-----	63
7. Referenca -----	65
SHTOJCAT-----	66

**GRAFIKËT**

Grafiku 1. Lloji i vendbanimit	21
Grafiku 2. Pjesëmarrja e huamarrësve sipas rajonit	21
Grafik 3. Shpërndarja e huamarrësve sipas profesioneve	21
Grafik 4. Të hyrat mujore të huamarrësve	23
Grafik 5. Shpenzimet dhe të hyrat neto mujore të ekonomive familjare	23
Grafik 6. Shpërndarja e kontratave aktive sipas produktit kreditor	26
Grafik 7. Shpërndarja e kontratave aktive sipas produktit kreditor, sektori bankar	26
Grafik 8. Shpërndarja e vlerës së aprovuar të kredive aktive sipas llojit të kredisë	27
Grafik 9. Shpërndarja e vlerës së mbetur të kredive aktive sipas llojit të kredisë	27
Grafik 10. Mesatarja e shumës së aprovuar dhe të mbetur borxh, sipas llojit të kredisë	28
Grafik 11. Shpërndarja e kredive aktive sipas vitit të aprovimit të kredisë	30
Grafik 12. Shpërndarja e kredive aktive sipas periudhës së maturimit	30
Grafik 13. Shpërndarja e kontratave aktive kreditore sipas qëllimit dhe institucioneve financiare	30
Grafik 14. Shpërndarja e kontratave aktive kreditore sipas produkteve kreditore dhe sipas qëllimeve të tyre	31
Grafik 15. Shuma e mbetur borxh, në mesatare, sipas qëllimit të kredisë dhe sipas institucioneve	31
Grafik 16. Shpërndarja e kredive aktive sipas llojit të kredisë dhe kolateralit	32
Grafik 17. Shpërndarja e kredive aktive sipas qëllimit të kredisë dhe kolateralit	32
Grafik 18. Shpërndarja e huamarrësve sipas numrit të kontratave kreditore	34
Grafik 19. Shpërndarja e huamarrësve sipas numrit të institucioneve me të cilët është krijuar kontrata kreditore	34
Grafik 20. Shpërndarja e huamarrësve sipas numrit të kontratave aktive kreditore dhe numrit të institucioneve	34
Grafik 21. Shpërndarja e huamarrësve sipas llojit të institucionit	34
Grafik 22. Shpërndarja e huamarrësve sipas numrit të kontratave aktive kreditore dhe llojit të institucionit	35
Grafik 23. Shpërndarja e huamarrësve sipas numrit të kontratave kreditore dhe llojit të banimit	35
Grafik 24. Shpërndarja e huamarrësve sipas numrit të kontratave kreditore dhe rajonit	35
Grafik 25. Shpërndarja e huamarrësve sipas llojit të kredisë dhe grupit të institucioneve kredidhënëse	36
Grafik 26. Pjesëmarrja e vlerës së llojeve të kredive në gjithsej portolion kreditore të huamarrësve	36
Grafik 27. Shpërndarja e kësit mujor sipas vlerës	36
Grafik 28. Shpërndarja e bashkëhuamarrësve sipas numrit të bashkëhuamarrjeve	37
Grafik 29. Shpërndarja e bashkëhuamarrësve sipas numrit të kontratave aktive kreditore	37
Grafik 30. Shpërndarja në bashkëhuamarrje e klientëve sipas gjinisë dhe vendbanimit	37
Grafik 31. Shpërndarja e huamarrësve sipas rolit bashkëhuamarrës dhe garantues	38
Grafik 32. Shpërndarja e huamarrësve sipas numrit të kontratave të garantuara	38
Grafik 33. Pjesëmarrja në garancione e huamarrësve sipas numrit të kontratave të veta kreditore	39
Grafik 34. Pjesëmarrja në garancione e huamarrësve sipas numrit dhe llojit të institucionit	39
Grafik 35. Shpërndarja e kontratave kreditore të vonuara në pagesë	39
Grafik 36. Shpërndarja e kontratave kreditore të vonuara në pagesë	40
Grafik 37. Pjesëmarrja e kontratave kreditore të vonuara në pagesë	40
Grafik 38. Huatë në vonesë (<30 ditë) dhe kolateralizimi	40
Grafik 39. Raporti i vlerës së kolateralit ndaj vlerës së huasë	41
Grafik 40a. Kontratat kreditore të vonuara në pagesë (>30 ditë) në sektorin bankar, sipas vitit të disbursimit	41
Grafik 40b. Kontratat kreditore të vonuara në pagesë (>30 ditë) në sektorin mikrofinanciar, sipas vitit të disbursimit	41

Grafik 41a. Ndryshimi vjetor i kreditimit, sektori bankar .....	42
Grafik 41b. Ndryshimi vjetor i kreditimit, sektori mikrofinanciar .....	42
Grafik 42. Kontrata kreditore të vonuara në pagesë (>30 ditë) sipas qëllimit dhe sektorëve .....	42
Grafik 43. Shpërndarja e huamarrësve sipas kohës së vonesës së kontratave .....	43
Grafik 44. Performanca e pagesës sipas numrit të kontratave dhe institucioneve .....	43
Grafik 45. Performanca e pagesës së huamarrësve sipas llojit të institucionit ku është klient .....	43
Grafik 46. Shuma e mbetur borxh e klientëve sipas vonesave dhe llojit të institucionit .....	44
Grafik 47. Shpërndarja e huamarrësve sipas numrit të kontratave kreditore dhe vonesave .....	44
Grafik 48. Performanca e pagesës së klientëve sipas performancës së kontratave ku janë garantues .....	44
Grafik 49. Performanca e pagesës së klientëve sipas performancës së kontratave mu janë bashkëhuamarrës .....	45
Grafik 50. Pjesëmarrja e ripagimeve me vonesë në gjithsej ripagimet sipas viteve .....	45
Grafik 51. Mesatarja e pjesëmarrjes së pagesave me vonesa sipas kohës së vonesës .....	46
Grafik 52. Mesatarja e pjesëmarrjes së pagesave me vonesë (>30 ditë) sipas vitit të lëshimit të kredive .....	46
Grafik 53. Shpërndarja e huamarrësve sipas indeksit kryesor të ngarkesës .....	46
Grafik 53a. Shpërndarja e huamarrësve sipas indeksit të ngarkesës për hua dhe mbitërheqje .....	47
Grafik 53b. Shpërndarja e huamarrësve sipas indeksit të ngarkesës për të gjitha produktet kreditore .....	47
Grafik 54. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas profesionit .....	47
Grafik 55. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas të hyrave mujore .....	48
Grafik 56. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas numrit të kontratave kreditore .....	49
Grafik 57. Niveli i ngarkesës së huamarrësve të shumëfishtë sipas numrit të institucioneve kredidhënëse .....	49
Grafik 58. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas llojit të institucionit .....	49
Grafik 59. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas klasifikimit kreditor .....	50
Grafik 60. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas statusit të kolateralizimit të huave .....	50
Grafik 61. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas historisë të huamarrësit .....	50
Grafik 62. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas rolit bashkëhuamarrë/garantues .....	50
Grafik 63. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas statusit të ristrukturimit të huave .....	50
Grafik 64. Ngarkesa me borxh e huamarrësit para dhe pas COVID-19 .....	51
Grafik 65. Shpërndarja e ekonomive familjare sipas indeksit kryesor të ngarkesës .....	52
Grafik 65a. Shpërndarja e ekonomive familjare sipas indeksit të ngarkesës për hua dhe mbitërheqje .....	52
Grafik 65b. Shpërndarja e ekonomive familjare sipas indeksit të ngarkesës për të gjitha produktet kreditore .....	52
Grafik 66. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas numrit të kontratave (huave) dhe institucioneve kredidhënëse .....	53
Grafik 67. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas numrit të kontratave kreditore .....	53
Grafik 68. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas llojit të institucionit me të cilin janë kontraktuar kreditë .....	53
Grafik 69. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas klasifikimit kreditor .....	53
Grafik 70. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas numrit të familjarëve të punësuar .....	54
Grafik 71. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas të hyrave mujore familjare .....	54
Grafik 72. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas statusit të kolateralizimit të huave .....	54
Grafik 73. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas statusit të ristrukturimit të huave .....	54
Grafik 74. Ngarkesa i ngarkesës së ekonomive familjare sipas historisë kreditore të huamarrësut .....	55
Grafik 75. Ngarkesa me borxh e ekonomive familjare para dhe pas pandemisë COVID-19 .....	55
Grafik 76. Shpërndarja e ekonomive familjare sipas indeksit neto të ngarkesës me borxh .....	56
Grafik 77. Indeksi neto i ngarkesës me borxh të ekonomive familjare para dhe pas shpërthimit të pandemisë COVID-19 .....	56

Grafik 78. Raporti i kësteve kreditore ndaj të hyrave familjare -----	57
Grafik 79. Raporti i kësteve kreditore ndaj të hyrave familjare sipas vendbanimit -----	57
Grafik 80. Raporti i kësteve kreditore ndaj të hyrave familjare sipas nivelit të të hyrave familjare-----	57
Grafik 81. Raporti i kësteve kreditore ndaj të hyrave familjare -----	58
Grafik 82. Ndikimi i krizës pandemike COVID-19 në të ardhurat familjare -----	58
Grafik 83. Pritjet për të ardhurat familjare në 3 muajt e ardhshëm -----	58
Grafik 84. Shpeshhtësia e vonesave më shumë se dy muaj në pagesën e shpenzimeve komunale -----	58
Grafik 85. Shpeshhtësia e vonesave më shumë se 2 muaj në pagesën e shpenzimeve komunale sipas vendbanimit të ekonomisë familjare -----	59
Grafik 86. Shpeshhtësia e vonesave më shumë se 2 muaj në pagesën e shpenzimeve komunale sipas të hyrave mujore të ekonomisë familjare -----	59

## TABELAT

Tabela 1. Rezultatet e treguesve objektiv dhe subjektiv të ngarkesës me borxh të Ekonomive familjare -----	08
Tabela 2. Burimet e të dhënave -----	13
Tabela 3. Treguesit e zakonshëm me borxh -----	18
Tabela 4. Karakteristikat socio-demografike të huamarrësve -----	22
Tabela 5. Statistikat përshkruese të të hyrave neto të ekonomive familjare -----	24
Tabela 6. Statistikat përshkruese të shumës së aprovuar të kontratave kreditore aktive (në euro) -----	28
Tabela 7. Statistikat përshkruese të shumës së mbetur të kredive aktive (në euro) -----	29
Tabela 8. Kohëzgjatja e kredive aktive (në vite) -----	29
Tabela 9. Vlera e aprovuar e kontratave kreditore aktive sipas kolateralizimit dhe sektorit, në euro -----	33
Tabela 10. Raporti i mbulesës së kontratave kreditore me kolateral dhe numri i njësisve të kolateralit, sipas sektorëve -----	33
Tabela 11. Niveli i ngarkesës dhe të hyrat mujore, kësti mujor, vlera e aprovuar dhe vlera e mbetur e huave (në euro) -----	48
Tabela 12. Observimet me të hyra të njëjta të huamarrësit dhe ekonominë familjare përkatëse, sipas numrit të anëtarëve të punësuar -----	52
Tabela 13. Të hyrat mujore , kësti mujor, vlera e aprovuar e kontratave aktive kreditore, dhe vlera e mbetur (në euro), sipas shkallës së ngarkesës së ekonomive familjare -----	55

## 1. HYRJJE

Më rritjen e vazhdueshme të kreditimit, veçanërisht rritjen më të lartë të kreditimit ndaj ekonomive familjare në periudhën e fundit, si dhe zgjerimin dhe rritjen e përdorimit të produkteve kreditore si kreditkartelat dhe mbitërheqjet, është rritur njëkohësisht edhe rreziku i mbingarkesës me borxh të ekonomive familjare. Ngarkesa me borxh e ekonomive familjare gjithnjë e më shumë po zgjon vëmendjen e politikbërësve, duke qenë se paraqet rrezik direkt në qëndrueshmërinë e borxhit të ekonomive familjare dhe në stabilitetin e sistemit financiar si tërësi. Për më tepër, ngarkesa e akumuluar e borxhit mund të shkaktoj edhe pasoja të tjera të mirëqenies sociale të huamarrësve duke rritur kështu ndjeshmërinë e tyre ndaj rrezikut të varfërisë dhe përjashtimit social.

Banka Qendrore e Kosovës (BQK), me qëllim të sigurimit të një mjedisi të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e sistemit financiar, si dhe për të siguruar stabilitet financiar, ka realizuar studimin e dytë me radhë për vlerësimin e ngarkesës me borxh të huamarrësve dhe ekonomive familjare respektive, që do të jetë mjet i rëndësishëm për informim të politikbërjes dhe vendimmarrjes. Studime të ngjashme që kanë hulumtuar dhe vlerësuar ngarkesën me borxh janë realizuar më herët nga BQK dhe EFSE (në vitin 2012 dhe 2015), por kanë qenë të fokusuar në ngarkesën vetëm në nivel të huamarrësit apo ndërmarrjeve, dhe kanë trajtuar vetëm segmente specifike të kreditimit.

Në këtë studim, BQK është zgjeruar në përfshirjen e pothuajse të gjitha institucioneve kredidhënëse në Kosovë (9 banka dhe 9 institucione mikrofinanciare), si dhe në përfshirjen e gjithësej gamës së produkteve kreditore për segmentin e kredive ndaj ekonomive familjare. Qëllimi kryesor i këtij studimi është të vlerësoj nivelin e ngarkesës me borxh të klientëve individual kreditor dhe të njësisë së tyre familjare. Përveç kësaj, studimi synon të identifikoj trendet e kreditimit, dallimet e mundshme në këto trende sipas karakteristikave socio-demografike dhe socio-ekonomike, si dhe modelet e huamarrjes, posaçërisht identifikimin e huamarrjes së shumëfishtë në institucione të ndryshme dhe sektorë të ndryshëm dhe ndërlidhjen e tyre me problemin e mbingarkesës.

Duke qenë se studimi është bërë në periudhën pas shfaqjes së pandemisë COVID-19, studimi do të tentoj të përfshijë edhe efektet e mundshme të krizës pandemike COVID-19 në të hyrat e ekonomive familjare, dinamikat e ngarkesës me borxh dhe aftësinë ripagueuse. Studimi është i strukturuar në kapitujt në vijim: 3) Metodologjinë e studimit, në të cilën elaborohet përzgjedhja e mostrës dhe kufizimet përcjellëse; 4) Interpretimin e rezultateve, e cila fillimisht elaboron mbi karakteristikat socio-demografike dhe socio-ekonomike të huamarrësve, pastaj modelet e huamarrjes (llojet dhe karakteristikat e kontratave kreditore), performancën e pagesës, dhe si përfundim, ngarkesën me borxh; 5) Përfundimin, që përmbledh gjetjet e studimit, përfshirë kufizimet si dhe 6) Rekomandimet për masa që mund të ndërmerren nga palët e interesit, për adresimin e problemeve të ndërlidhura me vlerësimin e nivelit të ngarkesës me borxh, posaçërisht në nivel të ekonomisë familjare.

Qëllimet specifike që studimi synon të adresoj janë:

- Karakteristikat socio-demografike dhe socio-ekonomike të huamarrësve me kredi aktive në institucione bankare dhe mikrofinanciare;
- Modelet më të shpeshta të huamarrjes ( lloji dhe qëllimi i kredive, vlera e aprovuar e kredisë, kohëzgjatja, përdorimi i kolateralit, bashkë-huamarrja, huamarrja e shumëfishtë në disa institucione);
- Karakteristikat e performancës ripagueuse dhe faktorët e mundshëm ndikues;
- Niveli i ngarkesës me borxh të huamarrësve individual dhe të ekonomive familjare;
- Ndikimi i shpërthimit të krizës pandemike COVID-19 në të hyrat dhe nivelin e ngarkesës së huamarrësit dhe ekonomisë së tij familjare.



## 2. Përmbledhje e rezultateve

Ngarkesa me borxh e ekonomive familjare nuk ka definicion dhe mënyrë standarde të vlerësimit për shkak të natyrës multi-dimensionale të problemit të ngarkesës/mbingarkesës. Tregues të ndryshëm përdorën për të vlerësuar aspekte specifike të ngarkesës, në mënyrë që të arrihet te një pasqyrë më reale e problematikës. Në këtë studim është bërë vlerësimi i ngarkesës përmes disa treguesve objektiv dhe subjektiv, si dhe është testuar dhe analizuar ndërlidhja mes tyre (Tabela 1).

**Tabela 1. Rezultatet e treguesve objektiv dhe subjektiv të ngarkesës me borxh të Ekonomive familjare**

Kategoria	Treguesi	Vlerësimi/Treguesi	Rezultati
Kosto e servisit të borxhit: Borxhi ndaj të hyrave	Ekonomitë familjare që shpenzojnë më shumë se 50% të hyrave bruto mujore në pagesën e borxhit (të siguruar dhe të pasiguruar)	a) <i>Indeksi i Ngarkesës me Borxh (shuma e kësteve mujore të huave aktive =&gt;50% e të hyrave mujore bruto të huamarrësit); (mostra 1,805)</i>	27.4% e huamarrësve shfrytëzojnë mbi 50% të të hyrave në pagesën e kësteve kreditore
		b) <i>Indeksi i Ngarkesës me Borxh (shuma e kësteve mujore të huave aktive =&gt;50% e të hyrave mujore bruto të ekonomisë familjare); (mostra 1,751)</i>	11.7% e ekonomive familjare shfrytëzojnë mbi 50% të të hyrave në pagesën e kësteve kreditore
	Ekonomitë familjare që shpenzojnë më shumë se 50% të hyrave bruto mujore në pagesën e borxhit (të siguruar dhe të pasiguruar)	<i>Anketa me ekonomitë familjare (mostra prej 1068 ekonomive familjare)</i>	a) 60.3 përqind e ekonomive familjare nuk posedojnë fare kredi aktive, ndërsa vetëm 1.9 përqind shfrytëzojnë më shumë se 50% të hyrave në pagesën e kredive, ndërsa 4.7 përqind nuk kanë dhënë përgjigje. b) Në kuadër të ekonomive familjare që kishin kredi aktive, 4.8 përqind e tyre shfrytëzojnë më shumë se 50 përqind të të hyrave familjare në pagesën e kësteve kreditore, ndërsa 11.7 përqind nuk kanë dhënë përgjigje.
Vonesat	Ekonomitë familjare me vonesa më shumë se 2 muaj në pagesën e kontratave kreditore	<i>Huamarrësit me vonesa më shumë se 60 ditë (mostra 1,984)</i>	8.5% e huamarrësve kanë vonesa më shumë se dy muaj në pagesën e kësteve kreditore. Shumica e tyre (74.4 %) janë në vonesë mbi 2 muaj në vetëm një kontratë kreditore.
	Ekonomitë familjare me vonesamë shumë se 2 muaj në pagesën e obligimeve të rregullta mujore për shpenzime komunale (uji, energjia elektrike, mbeturinat, tatimi në pronë),	<i>Anketa me ekonomitë familjare (mostra prej 1,068 ekonomive familjare)</i>	9% e ekonomive familjare shpeshherë kanë vonesa më të gjata se 2 muaj në pagesën e këtyre obligimeve; ndërsa 45.7 përqind, kanë deklaruar se vonohen ndonjëherë
Numri i kontratave kreditore	Ekonomitë familjare =>4 kontrata aktive kreditore	<i>Huamarrësit =&gt;4 kontrata aktive kreditore (mostra 1,984)</i>	17.7% e huamarrësve kanë 4 apo më shumë se 4 kontrata aktive kreditore

Burimi: BQK.

**Mbingarkesa me borxh të huave<sup>1</sup> variron nga 27.4 përqind, kur merren për bazë vetëm të hyrat e huamarrësit, në 11.7 përqind kur merren për bazë të hyrat e gjithë njësisë familjare.** Mbingarkesa me borxh bazuar vetëm në të hyrat e huamarrësit mund të reflektoj mbivlerësim të gjendjes së ngarkesës, për shkak të bashkë-huamarrjeve dhe faktit se ekonomitë familjare bashkojnë të hyrat për të mbuluar shpenzimet. Në anën tjetër, në vlerësimin e mbingarkesës me të hyra të ekonomisë familjare, për shkak të mungesës së informacionit për borxhin e mundshëm të huave të anëtarëve tjerë të familjes, mund të kemi pasqyrë të nënvlerësuar të nivelit të ngarkesës. Andaj, rezultatet e mbingarkesës nuk duhet të interpretohen si vlerësim absolut i gjendjes faktike, por si indikacion i nivelit të përafërt të mbingarkesës së ekonomive familjare me hua në sektorin financiar në Kosovë, i cili konsiderohet të jetë në intervalin ndërmjet rezultateve të lartcekura nga të dy indikatorët (me të hyra të huamarrësit dhe atij me të hyra të njësisë familjare).

**Në fazën e parë të mbingarkesës - në rrezik për mbingarkesë ngase kësti mujor i huasë përbën 50 deri në 75 përqind së të hyrave mujore - janë 21.8 përqind të huamarrësve.**

<sup>1</sup> Mbingarkesa përfshinë rastet kur niveli i borxhit mujor vetëm për huatë (shuma e kësteve mujore të huave, duke mos përfshirë produktet tjera kreditore si mbitërheqjet dhe kreditkartelat) tejkalon 50 përqind së të hyrave mujore.

Ndërsa, kur merren parasysh të hyrat e gjithë njësisë familjare, në rrezik për mbingarkesë janë 8.2 përqind të ekonomive familjare. **Në fazën kritike - me raport të borxhit ndaj të hyrave në intervalin 75 deri 100 përqind** - rezultojnë 3.8 përqind e huamarrësve dhe 2.0 përqind e ekonomive familjare. Rastet kur shpenzimet e kësteve të huamarrësit tejkalojnë plotësisht të hyrat mujore bruto duke kaluar në **gjendje jo-solvente**, paraqiten në 1.8 përqind të mostrës së huamarrësve dhe 1.4 përqind të ekonomive familjare.

**Niveli i ngarkesës me borxh të huamarrësve asocohet me huamarrjen e shumëfishtë, në veçanti me posedimin e shumë kontratave aktive kreditore në institucione të ndryshme.** Huamarrësit e shumëfishtë në institucione të ndryshme kishin pothuajse dy herë më shumë raste të mbingarkesës me borxh, përkatësisht 40.5 përqind e tyre (22.2 % e ekonomive familjare) ishin të mbingarkuar me borxh, krahasuar me 24.2 përqind të huamarrësve të shumëfishtë në institucionin e njëjtë (7.5 % për ekonomitë familjare). Probabiliteti i të qenit në fazë kritike të ngarkesës dhe në gjendje jo-solvente gjithashtu ishte dukshëm më i lartë për huamarrësit e shumëfishtë dhe atë në disa institucione (mesatarisht raport 85:15, që nënkupton që nga gjithsej huamarrësit në kategorinë përkatëse të mbingarkesës, 85 përqind janë huamarrës të shumëfishtë, dhe atë në disa institucione).

**Huamarrësit dhe ekonomitë familjare me kredi aktive në sektorin bankar janë më të mbingarkuar se huamarrësit me kredi aktive në sektorin mikrofinanciar.** Ndërsa, probabiliteti i mbingarkesës është më i larti te huamarrësit dhe ekonomitë familjare me kredi aktive në të dy sektorët. Huamarrësit me kontrata kreditore vetëm në sektorin bankar ishin të mbingarkuar në 25.7 përqind të rasteve (9.7% të ekonomive familjare), krahasuar me 15.6 përqind të huamarrësve me kredi vetëm në sektorin mikrofinanciar (6.2% të ekonomive familjare). Po ashtu shkalla e huamarrësve jo-solvent është më e lartë për huamarrësit me kredi vetëm në sektorin bankar, në 1.7 përqind të rasteve, krahasuar me vetëm 0.3 përqind të huamarrësve me kredi vetëm në sektorin mikrofinanciar. Por, me konsiderimin e të hyrave të ekonomisë familjare, shkalla e paaftësisë paguese të borxhit për huamarrësit me kredi vetëm në sektorin bankar bie në nivel më të ulët se të sektorit mikrofinanciar (0.6 përqind, përkatësisht 0.8 përqind).

**Për vlerësimin e problemit të mbingarkesës janë eliminuar këstet e produkteve tjera kreditore si kreditkartelat dhe mbitërheqjet, për shkak të vështirësive në kuantifikimin e këstit të tyre mujor.**<sup>2</sup> Këto produkte, megjithëse mund të jenë burim i vazhdueshëm i borxhit për huamarrësit, me efekt të konsiderueshëm në rritjen e mbingarkesës së tij, kanë mundësi që gjithashtu të reflektojnë gjendje të përkohshme të borxhit (shfrytëzim i njëhershëm i produktit). Në mungesë të informacionit mbi këstet kreditore, vlerësimi i ngarkesës me borxh kur përfshihen pagesat e këtyre produkte kreditore është realizuar nën supozimin se gjithsej borxhit i mbetur në kreditkartelë dhe mbitërheqje është këst mujor. Për shkak të këtij supozimi konservativ, shkalla e huamarrësve të mbingarkuar rezulton shumë më e lartë, dhe konsiderohet e mbivlerësuar. Andaj, këto rezultate janë raportuar shkurtimisht në pjesën e rezultateve por nuk janë analizuar tutje.

**Problemet në performancën e pagesës rezultuan të jenë të ndërlidhura me nivelin më të lartë të ngarkesës me borxh.** Huamarrësit me vonesa kishin pothuajse dy herë më shumë raste të mbingarkesës me borxh, përkatësisht 40.0 përqind e huamarrësve me vonesa (21.6 % e ekonomive familjare) ishin të mbingarkuar me borxh, krahasuar me 26.1 përqind të huamarrësve që kishin performancë të rregullt të pagesës (10.6 % për ekonomitë familjare). Gjithashtu, rastet e mos-aftësisë paguese të borxhit (jo-solvensës) ishin më të shpeshta në mesin e huamarrësve me

<sup>2</sup> Kreditkartela është produkt kreditor që ka kushte të ndryshme të pagesës. Pagesa e borxhit të shfrytëzuar mund të paguhet në tërësi apo i ndarë në kohë, sipas kushteve të përcaktuara nga bankat dhe preferencat e shfrytëzuesve. Mbitërheqja është produkt kreditor që lejon shfrytëzimin e fondeve nga klienti kur llogaria e tij ka arritur në zero. Klienti paguan interes në shumën e shfrytëzuar te limitit të paralejuar të mbitërheqjes, varësisht nga shfrytëzimi, ndërsa kthimi i gjithsej borxhit të mbitërheqjes bëhet vetëm në maturim.

vonesa, me ç'rast 2.3 përqind të huamarrësve me vonesa (4.1% e ekonomive familjare) rezultojnë jo-solvent krahasuar me vetëm 1.7 përqind të huamarrësve pa vonesa (1.1 % ekonomi familjare).

**Tendencat më të larta të vonesave në pagesën e kredive ishin në mesin e huamarrësve të shumëfishtë (më shumë se një kontratë kreditore aktive), por nga institucione të ndryshme.** Rreth një çerek e huamarrësve të shumëfishtë, me produkte kreditore në institucione të ndryshme, janë në vonesë, krahasuar me vetëm 2.0 përqind të huamarrësve të shumëfishtë por në të njëjtin institucion. Pjesëmarrja e huamarrësve me vonesa më shumë se 2 muaj ishte 8.5 përqind, shumica e të cilëve (74.4%) ishte në vonesë në vetëm një kontratë kreditore. Probabiliteti i vonesave të huamarrësve rritet me rritjen e numrit të kontratave kreditore, me ç'rast huamarrësit me katër e më shumë kontrata kreditore kishin më së shumti vonesa.

**Ngarkesa me borxh e huamarrësve dhe ekonomive familjare rezulton më e lartë në periudhën pas shfaqjes së pandemisë COVID-19.** Indeksi i ngarkesës pas shfaqjes së pandemisë COVID-19 rezulton më i lartë mesatarisht për nga 2 pikë përqindje për secilën prej kategorive të ngarkesës. Sidoqoftë, këto rezultate nuk reflektojnë plotësisht ndikimin e pandemisë dhe përgjithësisht duhet të merren me rezervë për shkak të mos-konsistencës së periudhës kohore që të dhënat reflektojnë.<sup>3</sup> Gjithashtu, të dhënat pas pandemisë nuk janë të plota<sup>4</sup> dhe në shumë raste janë mbledhur në formë të anketimit, që krijon hapësirë për subjektivitet.

**Sipas indeksit neto të ngarkesës me borxh të ekonomive familjare<sup>5</sup>, niveli i mos-aftësisë paguese të borxhit rezulton i lartë.** Përkatësisht 13.7 përqind e huamarrësve kanë vlerë të borxhit (këste kreditore të huave) më të lartë se të hyrat neto nga shpenzimet e rregullta mujore. Në 1.9 përqind të rasteve, shpenzimet mujore të rregullta janë raportuar më të larta se të hyrat bruto të ekonomisë familjare. Ky fakt, si dhe pjesëmarrja e lartë e huamarrësve jo-solvent sugjerojnë për kufizim të shprehur në të dhënat e raportuara, që konsiderohet të kenë ndikuar në mbivlerësim të gjendjes së ngarkesës.

**Vlerësimi i mbingarkesës me borxh të ekonomive familjare, sipas një ankete të porositur nga BQK, e realizuar në mostër tjetër të ekonomive familjare, rezulton më i ulët.** Rezultatet e anketës me ekonomi familjare sugjerojnë që 60.3 përqind e ekonomive familjare nuk posedojnë fare kredi aktive. Ngarkesa me borxh, përkatësisht shfrytëzimi i më shumë se 50 përqind të hyrave familjare në pagesën e kësteve kreditore, ka rezultuar prezent në vetëm 1.9 përqind të rasteve. Ndërsa, në kuadër të ekonomive familjare që kishin kredi aktive, vetëm 4.8 përqind e tyre shfrytëzojnë më shumë se 50 përqind të të hyrave familjare në pagesën e kësteve kreditore.

**Rezultatet e anketës sugjerojnë që 9 përqind e ekonomive familjare shpeshherë kanë vonesa më të gjata se 2 muaj në pagesën e obligimeve të rregullta mujore për shpenzime komunale (uji, energjia elektrike, mbeturinat, tatimi në pronë).** Përqindje e lartë, 45.7 përqind, kanë deklaruar se vonohen ndonjëherë, ndërsa 28.5 përqind kanë thënë se rrallëherë kanë vonesa të tilla. **Sipas anketës, shpërthimi i pandemisë COVID-19 ka pasur efekt të ndryshëm në të ardhurat e ekonomive familjare.** Një e treta e ekonomive familjare,

<sup>3</sup> Koha e regjistrimit të të hyrave para pandemisë nuk është konsistente ndërmjet institucioneve financiare. Përderisa disa prej tyre kanë raportuar të dhënat në muajin e fundit para shpërthimit të pandemisë, të tjerat kanë raportuar të hyrat e huamarrësve të datës së dhënies/aprovimit të kredisë.

<sup>4</sup> Ndryshimet në këstet kreditore, përkatësisht ristrukturimet, nuk janë të plota. Këstet e ristrukturuara si pasojë e Covid-19 janë pranuar nga Institucionet Financiare për kreditë aktive të klientëve të tyre (klientëve të përzgjedhur si mostër për institucionin përkatës). Mirëpo, për llogaritjen e borxhit të përgjithshëm të klientit, përkatësisht ekonomisë familjare, janë marrë (mbledhur) të gjitha këstet e të gjitha produkteve kreditore aktive që kanë figuruar në RKK. Andaj, ristrukturimet tjera që huamarrësit mund të kenë pasur në institucione tjera financiare mund të mos jenë reflektuar në RKK.

<sup>5</sup> Indeksi neto i ngarkesës së ekonomisë familjare paraqet raportin e shumës së kësteve mujore të huamarrësit ndaj të hyrave mujore neto të ekonomisë familjare (të hyrat mujore bruto të zbritura për shpenzimet e rregullta mujore të ekonomive familjare për pagesën e shpenzimeve komunale).

përkatësisht 35.6 përqind, janë deklaruar se të hyrat e familjes nuk kanë ndryshuar që nga shpërthimi i pandemisë COVID-19. Në anën tjetër, pjesëmarrje pak më e ulët, 31.1 përqind, kanë deklaruar se të hyrat e familjes së tyre janë zvogëluar. Pjesa tjetër prej 27.8 përqind kanë thënë që kanë pasur rënie të përkohshme të hyrave të cilat janë rikthyer në gjendjen paraprake, ndërsa 5.5 përqind kanë deklaruar se të hyrat familjare janë rritur.

Si përfundim, tregues të ndryshëm vlerësuan aspekte të ndryshme të mbingarkesës, të cilat së bashku japin informacion të rëndësishëm mbi nivelin e ngarkesës së ekonomive familjare në Kosovë. Rezultatet sugjerojnë se mbingarkesa asocohet me huamarrje të shumëfishtë dhe performancë më të dobët të pagesës. Megjithatë, duhet të theksohet se relacioni shkak-pasojë ndërmjet këtyre faktorëve nuk është i përcaktuar, dhe mund të zhvillohet në kahje të ndryshme: posedimi i më shumë kontratave kreditore patjetër ndikon në rritjen e borxhit mujor për pagesë dhe ka ndikim në rritjen e nivelit të ngarkesës me borxh të huamarrësve; megjithatë, ekziston mundësia që huamarrësit të marrin borxh shtesë për servisim të borxhit ekzistues në rastet e pamundësisë së pagesës, dhe në këtë mënyrë të ndikojnë në mbingarkesë. Gjithashtu, vonesat në pagesë nuk nënkuptojnë domosdo ngarkesë me borxh të huamarrësve, meqë ato mund të paraqesin ndryshime të përkohshme në të hyrat dhe shpenzimet e huamarrësve. Si dhe, ngarkesa me borxh nuk rezulton gjithnjë në vonesa, ngase huamarrësit mund të përdorin burime të tjera të pagesës së borxhit kreditor, siç janë kursimet, huamarrjet nga familjarët, etj.

### 3. Metodologjia e studimit

#### 3.1. Burimi i të dhënave

Studimi tenton të matë ngarkesën me borxh të huamarrësve dhe ekonomive familjare të tyre përmes shfrytëzimit të të dhënave të Regjistrimit të Kredive të Kosovës (RKK) dhe të dhënave të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të institucioneve bankare dhe mikrofinanciare kredidhënëse. Burimi kryesor i të dhënave është RKK, platformë në të cilën raportojnë të gjitha institucionet financiare kredidhënëse në baza të rregullta. Por, meqenëse në RKK reflektohet vetëm gjendja financiare e huamarrësit, sigurimi i informacioneve për gjendjen financiare (të hyrat dhe shpenzimet) të ekonomisë familjare të huamarrësit respektiv është realizuar përmes kërkesës nga institucionet kredidhënëse.

Nga institucionet financiare kredidhënëse janë siguruar gjithashtu të dhëna shtesë socio-demografike të huamarrësve si dhe të dhëna për kreditë, me qëllim të plotësimit ndërmjet dy databazave si dhe krahasimit/vlerësimit të kualitetit të informacionit. Institucionet financiare janë kërkuar që të sigurojnë të dhënat për të hyrat dhe shpenzimet mujore të ekonomisë familjare ndaras për periudhën para pandemisë COVID-19 dhe pas shfaqjes së pandemisë, për të reflektuar ndryshimin e mundshëm si pasojë e krizës. Në kuadër të të dhënave për kreditë që janë kërkuar nga institucionet financiare, me rëndësi të veçantë kanë qenë informacionet për ristrukturimet e kredive si pasojë e pandemisë COVID-19, informata të cilat nuk janë të plota në RKK.

**Tabela 2. Burimet e të dhënave**

	RKK	Institucionet financiare
<b>Të dhënat socio-demografike</b>	Rajoni, gjinia, mosha, profesioni	Numri i anëtarëve të ekonomisë familjare
<b>Modelet e huamarrjes</b>	Llojet e kredisë, të dhënat mbi shumën e aprovuar dhe të mbetur borxh për të gjitha kontratat kreditore, data e aprovimit dhe e maturimit të kredive.	Të njëjtat të dhëna të kërkuara në RKK (për qëllime të plotësimit me njëra tjetrën), përfshirë edhe qëllimin e kredisë.
<b>Niveli i ndërlidhjes së huamarrësve</b>	Burimi i kontratave kreditore (institucionet nga është marrë kredia) dhe karakteristikat e kontratave kreditore	-
<b>Garantuesit dhe bashkë-huamarrësit</b>	Statusi nëse huamarrësit janë të përfshirë në rolin e garantuesit apo/dhe bashkë-huamarrësit.	-
<b>Performanca e pagesës</b>	Klasifikimi kreditor i ripagimit për të gjitha kontratat kreditore.	Për kontrata kreditore të institucioneve përkatëse: klasifikimi kreditor, numri i ditëve në vonesë dhe shuma e mbetur në vonesë për ripagim.
<b>Niveli i ngarkesës me borxh</b>	Të hyrat mujore Kësti mujor	Të hyrat mujore individuale (me qëllim të verifikimit edhe me të dhënat në RKK dhe përditësimit të tyre konform informacioneve të marra nga IF-të) Kësti mujor (në mungesë të informacionit në RKK) Të hyrat mujore të ekonomive familjare Shpenzimet e ekonomive familjare për pagesën e shërbimeve komunale dhe energjisë

Burimi: BQK.

Informacioni për njësinë familjare nuk ka qenë i disponueshëm në shumicën e rasteve as nga vet institucionet financiare (në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit apo në Dosjet e kredive të huamarrësve, institucionet financiare disponojnë me të dhëna vetëm për huamarrësin dhe potencialisht bashkë-huamarrësit/garantuesit), ndaj ky informacion është siguruar veçanërisht për qëllime të këtij studimi. Mënyra e sigurimit të tij ka qenë në diskrecion të institucioneve financiare, disa nga të cilat kanë realizuar anketim me shkrim me huamarrësit e tyre.

Në rastin e ndërtimit të databazës përfundimtare për analizë të kontratave kreditore, përparësi në shfrytëzim kishin të dhënat nga RKK, përderisa në bazën përfundimtare të informacionit në nivel të huamarrësit, përparësi iu është dhënë të dhënave nga institucionet financiare, nën supozimin se mund të jenë më të azhurnuara. Në rast të mungesës së të dhënave të njëjta nga cilado databazë, është bërë plotësimi prej bazës tjetër ku informacioni ishte i disponueshëm (Tabela 2).

Burim shtesë i informacionit për vlerësimin e ngarkesës me borxh të ekonomive familjare është edhe një anketim mbi ngarkesën e ekonomive familjare, i porositur nga BQK dhe i realizuar nga Ubo Consulting<sup>6</sup>, përmes produktit të tyre të hulumtimit të opinionit publik ‘Omnibus’.

Në këtë anketë parashtrihen pyetje që synojnë marrje të informacionit/vlerësim të ngarkesës me borxh në aspekte që nuk janë në dispozicion përmes studimit, por edhe pyetje që vlerësojnë aspektet e njëjta, por që shërbejnë si informacion shtesë për vlerësimin e mundshëm të gjendjes së ngarkesës së ekonomive familjare. Mostra e ekonomive familjare është e ndryshme, sidoqoftë, konsiderohet që rezultatet e anketës janë informative për vlerësimin e problematikës së përgjithshme të ngarkesës për qëllime të vlerësimit të rrezikut kreditor dhe politik-bërjes.

### 3.2. Mostra e studimit

Mostra e përgjithshme e studimit është përzgjedhur nga popullimi i klientëve individual së të gjitha institucioneve bankare dhe mikrofinanciare në Kosovë, që kishin së paku një kontratë kreditore aktive në RKK në fund të muajit mars 2021. Të dhënat mbi gjithsej numrin e klientëve individual me nga së paku një kredi aktive për secilin institucion financiar kredidhënës janë marrë nga RKK. Në kuadër të sektorit bankar, janë përfshirë të gjitha bankat dhe degët bankare në Kosovë të cilat kreditojnë sektorin e ekonomive familjare, pavarësisht pjesëmarrjes në këtë segment.<sup>7</sup> Ndërsa sa i përket institucioneve kredidhënëse mikrofinanciare, në studim janë përfshirë vetëm institucionet me pjesëmarrje në këtë segment të tregut më të lartë se 0.22 përqind (së paku 5 klientë).<sup>8</sup> Përfundimisht, në studim përfshihen klientët individual të nëntë bankave komerciale dhe nëntë institucioneve mikrofinanciare,<sup>9</sup> me kredi aktive në mars 2021. Bazuar në shtrirjen në treg të institucioneve të përfshira në studim në muajin mars 2021, mostra përfaqëson 99.4% të gjithësej tregut të kredive në aspektin e numrit të klientëve për segmentin e përcaktuar.

Mostra, e cila është përzgjedhur duke respektuar nivelin e besueshmërisë prej 99% dhe me margjinën e gabimit 3%, fillimisht përfshinte 1,841 klientë. Kjo mostër fillestare është rritur për 10.0% për të reflektuar mundësinë e përzgjedhjes së klientëve të njëjtë nga më shumë se një institucion, si dhe mundësinë e mungesës së plotë së të dhënave apo dhe gabimeve eventuale. Pas rregullimeve dhe eliminimeve për shkak të mungesës së disa informacioneve dhe pamundësisë së sigurimit të tyre, mostra përfundimtare e studimit përfshinë 1,991 klientë individual me 10,738

<sup>6</sup> UBO Consulting është kompani vendore e hulumtimeve të tregut dhe e konsulencës biznesore, e cila është anëtare e Shoqatës Evropiane për Opinion dhe Hulumtime mbi Tregun (ESOMAR), Shoqatës Botërore për Hulumtime të Tregut, Sociale dhe të Opinionit Publik.

<sup>7</sup> Banka Credins, në datën e përzgjedhjes së mostrës, nuk ka pasur kredi aktive për individë.

<sup>8</sup> Monego dhe lute Credit nuk janë të përfshirë për shkak të revokimit të licencës së operimit.

kontrata kreditore (nga të cilat 5,014 kontrata aktive kreditore). Sidoqoftë, mostra ndryshon për tregues të ndryshëm të vlerësimit të mbingarkesës, në varësi të informacionit në dispozicion, ndaj dhe numri i mostrës është raportuar krahas secilit tregues.

Shpërndarja e mostrës për institucionet e përfshira në studim është bërë në proporcion me pjesëmarrjen e këtyre institucioneve përkatëse në gjithsej segmentin e përzgjedhur të tregut, respektivisht pjesëmarrjen në segmentin e kreditimit ndaj ekonomive familjare.

### 3.2.1 Procedura e përzgjedhjes së mostrës së studimit

Në mënyrë që mostra të jetë valide dhe reprezentative për popullacionin, ajo është përzgjedhur në mënyrë të rastësishme, nga autoret e studimit, analiste në Departamentin e Analizave Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar (DAESF) të BQK-së. Me qëllim të ruajtës së konfidencialitetit së të dhënave, listat e klientëve me kredi aktive në institucionet financiare janë koduar nga RKK me një numër unifikues për identifikim dhe janë dërguar në DAESF për përzgjedhje të rastësishme. Mostra e klientëve të përzgjedhur, e plotësuar nga RKK me numrin identifikues të klientëve dhe kodin unik të krijuar për secilin klient, është përcjellë tek institucionet financiare për plotësim. Për të njëjtën mostër të klientëve, RKK ka ekstraktuar të dhënat nga baza e tyre e të dhënave, dhe pas kodimit, janë dërguar te Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar për përpunim.

### 3.2.2. Mostra e anketës me ekonomi familjare

Mostra për anketën e ekonomive familjare të realizuar nga Ubo Consulting është 1,068 ekonomi familjare. Mostra është e shtresuar sipas etniciteteve si dhe e balancuar në aspekt të gjinisë dhe llojit të vendbanimit. Më specifikisht, përfaqësimi gjinor i mostrës është 50.4% burra dhe 49.6% gra. Ndërsa përfaqësimi në aspektin e llojit të vendbanimit është: urban 44.4% dhe 55.6% rural.

Margjina e gabimit është  $\pm 3\%$  në përzgjedhje për interval të konfidencës 95%. Përzgjedhja e ekonomive familjare është bërë duke shfrytëzuar metodën sistematike të rastësisë, si dhe anketimi është realizuar me personin mbi 18 vjet me ditëlindjen e parë më të afërt. Anketimi është bërë në periudhën 15 – 23 Mars 2021.

### 3.3. Kufizimet e të dhënave të shfrytëzuara

Procesi i përpilimit të këtij studimi është ballafaquar me shumë sfida në sigurimin e të dhënave, si dhe kufizime në kualitetin e tyre. Këto kufizime janë reflektuar në mbi/ nën vlerësimin e rezultateve të caktuara, andaj rekomandohet që interpretimi i gjetjeve të këtij studimi të bëhet duke marrë parasysh kufizimet dhe supozimet përkatëse.

#### 3.3.1. Kualiteti i të dhënave

Informacioni për të hyrat dhe shpenzimet mujore të ekonomive familjare është siguruar nga institucionet financiare veçanërisht për qëllime të këtij studimi, përmes anketimit standard apo kontaktit individual me huamarrësit. Ky proces i marrjes së të dhënave, për të cilat mungon kuadri rregullativ që obligon raportimin e tyre si dhe mungojnë mekanizmat për dokumentim të tij (kontratë pune apo qarkullim bankar), krijon hapësirë për skepticizëm në saktësinë e informacionit. Në shumë raste, huamarrësit kanë refuzuar të shpalosin të hyrat dhe shpenzimet familjare, gjë që ka detyruar në ndryshim të mostrës fillestare (janë përzgjedhur huamarrës shtesë për institucionet përkatëse, në mënyrë që të sigurohet numri minimal i kërkuar i mostrës së huamarrësve me informacion të plotë). Sidoqoftë, edhe në rastin e sigurimit të informacionit, mungesa e mekanizmave për konfirmim të tij, lejon hapësirë për dyshime në kualitet apo subjektivitet (mbi apo nën vlerësim/deklarim i informacionit të kërkuar).

Dyshimet e lartë cekura janë vërtetuar edhe nga fakti se:

- a) Në shumë raste, të hyrat e ekonomive familjare janë raportuar të njëjta me ato të huamarrësve, përkundër faktit që janë raportuar më shume se një i punësuar në njësinë familjare;
- b) Të hyrat e ekonomisë familjare janë raportuar më të ulëta se të hyrat e huamarrësve;
- c) Shpenzimet mujore të ekonomisë familjare, të cilat përfshijnë shpenzimet mujore të jetesës duke mos përfshirë pagesat e kësteve kreditore, janë raportuar më të larta se të hyrat e njësisë familjare;

Përkundër që janë bërë përpjekje dhe janë korrigjuar të dhënat e raportuara në bashkëpunim me institucionet financiare përkatëse në rastet e lëshimeve teknike, shqetësimet për kualitetin e informacionit që huamarrësit kanë deklaruar mbasin. Ky shqetësim mbi saktësinë, i theksuar edhe nga vetë institucionet financiare, duhet të merret parasysh në interpretimin e rezultateve të ngarkesës me borxh të ekonomive familjare.

Në rastin e vlerësimit të ngarkesës me borxh të ekonomisë familjare, problem tjetër që reflektohet në vlerësimin jo real (përkatësisht nënvlerësimin e ngarkesës), është mungesa e plotë e informacionit mbi borxhin e njësisë familjare. Në mungesë të informacionit të borxhit së të gjithë anëtarëve të ekonomisë familjare, borxhi i huamarrësit (shuma e kësteve kreditore të huamarrësit në të gjitha institucionet financiare, e siguruar përmes regjistrimit të kredive) është konsideruar si borxh i njësisë familjare. Në këtë rast, kur të hyrat përfshijnë të hyrat e deklaruara në nivel të njësisë familjare, ndërsa borxhi përfshinë vetëm borxhin e huamarrësit, indeksi i ngarkesës me borxh ka tendencë të jetë i nënvlerësuar.

Në rastin e indeksit neto të ngarkesës i cili merr për bazë gjithashtu të dhënat e shpenzimeve të rregullta mujore të ekonomisë familjare, përveç problemit të mësipërm të mungesës së plotë të borxhit, është edhe dyshimi rreth saktësisë së të dhënave mbi shpenzimet. Në 1.9 përqind të rasteve, shpenzimet mujore të ekonomisë familjare (pas korrigjimeve të mundshme) rezultojnë më të mëdha se të hyrat e ekonomisë familjare.

Andaj, përderisa rezultatet e ngarkesës së ekonomisë familjare duhet të interpretohen me rezervë, konsiderohet se rezultatet e ngarkesës së huamarrësve individual pasqyrojnë vlerësim më objektiv të gjendjes. Të dhënat për të hyrat mujore të huamarrësve janë të dhëna të cilat institucionet kredidhënëse kryesisht i kanë të dokumentuara përmes kontratave të punësimit apo deklarimeve bankare së të hyrave mujore. Këto informata, në shumicën e rasteve, plotësohen nga institucionet financiare në momentin e lëshimit të kredisë dhe ruhen në dosjet e kredive të huamarrësve përkatës.

Edhe në rastin e të hyrave të huamarrësve, janë disa aspekte të cilësisë së informacionit që duhet të theksohen:

- a) Dimensioni i kohës, që nënkupton kohën e regjistrimit së të hyrave mujore të huamarrësve dhe ndryshimin e tyre eventual përgjatë periudhës së zgjatjes së kontratës kreditore. Të hyrat për huamarrës mbledhen nga institucionet kredidhënëse në momentin e lëshimit të kredisë dhe nuk përditësohen në baza të rregullta përgjatë periudhës sa zgjatë kontrata kreditore. Kjo bën që të dhënat në dispozicion të mos reflektojnë ndryshimet e mundshme në të ardhura në periudhën pas aprovimit të kredisë, e cila ndikon në kapacitetin e kredimarrësit për të ripaguar borxhin. Kjo problematikë mbi të hyrat që nuk janë të azhurnuara mund të ketë ndikim në mbi apo nënvlerësimin e rezultateve për nivelin e ngarkesës. Në supozimin që të hyrat nuk janë azhurnuar nga koha e lëshimit të kontratave kreditore, është kërkuar që institucionet financiare të paraqesin të dhënat e azhurnuara pas paraqitjes së pandemisë COVID-19. Sidoqoftë, për shkak të ndryshimit të



mundshëm së të hyrave nga koha e lëshimit të kontratës, krahasimi para dhe pas pandemisë COVID-19 i të hyrave mund të mos reflektoj plotësisht efektin e pandemisë por këto azhurnime eventuale.

- b) Mospërputhje e të dhënave të huamarrësve ndërmjet dy bazave së të dhënave, përkatësisht RKK-së si dhe informacionit të dërguar nga institucionet financiare, që mund të jetë rezultat i problemit të lartcekur të dimensionit kohor, apo gabimeve eventuale në raportim. Mospërputhjet më të theksuara rezultuan në rastet e kësteve kreditore (16.1 përqind të gjithsej kredive), shumës së mbetur borxh (17.8 përqind), qëllimit të kredisë (7.95 përqind), profesionit (21.9 përqind), komunës (15.7 përqind). Në rast të mospërputhjeve, janë mbajtur informacionet e dërguara nga institucionet financiare, për shkak të supozimit se jenë më të azhurnuara.

### 3.3.2. Mungesa e të dhënave të sakta për këstet e kredive

Shuma e këstit të kredisë, megjithëse tashmë është variabël që kërkohet detyrimisht të raportohet në Regjistrin e Kredive, në shumë raste mungon për produktet kreditore si mbitërheqjet (kësti mungon në 79.7 përqind të mbitërheqjeve aktive) dhe kreditkartelat (kësti mungon në 98.5 përqind të kreditkartelave aktive). Shuma e këstit të këtyre produkteve kreditore për huamarrësit e përfshirë në studim është marrë nga të dhënat e institucioneve financiare, mirëpo vetëm për rastet kur këto produkte ishin të lëshuara nga po ato institucione. Ndërsa në rastin kur huamarrësit në mostër kanë produkte kreditore nga institucione të tjera financiare, dhe në mungesë të shumës së këstit të këtyre produkteve, është dashur të bëhen supozime për të kalkuluar shumën e përgjithshme që klientët e paguajnë për shlyerjen e këtyre borxheve.

Në rastin e kreditkartelave, në mungesë të informacionit mbi ndarjen e mundshme të borxhit aktiv në këste kreditore, është supozuar që gjithsej borxhi i mbetur për pagesë është këst mujor kreditor. Në rastet kur kishte vonesë në pagesë, është aplikuar edhe interesi ndëshkimor.

Ndërsa, për mbitërheqjet si dhe huatë, në rastin e mungesës së informacionit të këstit (vetëm 1.7 përqind e huave dhe lizingut aktiv kishin mungesë të kësteve kreditore), llogaritja është bërë fillimisht duke shfrytëzuar informacionin mbi koston e përgjithshme të kredisë dhe normën efektive të interesit, të raportuara në RKK. Për mbitërheqjet, gjithsej shuma e mbetur borxh është konsideruar si këst mujor ndërsa për huatë, kësti mujor është llogaritur nën supozimin e pagesave të barabarta gjatë gjithë kohëzgjatjes së huasë. Llogaritja e këstit është bërë duke supozuar që kontrata kreditore ka normë të interesit të barabartë me mesataren e normës së interesit të ofruar nga të gjitha institucionet (veçantë për banka dhe mikrofinanca) për produktin kreditor përkatës.

Normat mesatare vjetore të interesit të përdorura për llogaritjen e këstit, të ndara sipas produkteve kreditore dhe sektorëve janë si në vijim:

- Hua<sup>10</sup> dhe lizing:
  - a) Sektori bankar: 6.24 %
  - b) Sektori mikrofinanciar: 21.83%
- Mbitërheqje në sektorin bankar: 14.97%
- Kreditkartelë (Norma mujore ndëshkuese për shumën e vonuar): 32.0%

<sup>10</sup> Huaja nënkupton produktin kreditor klasik, përkatësisht huatë me maturitet dhe normë përkatëse të interesit që huamarrësi detyrohet t'i paguaj institucionit kreditor për shfrytëzimin e huasë për gjatë gjithë kohës së maturimit. Pagesa e huasë bëhet në këste kreditore (zakonisht të barabarta). Në këtë studim, me termin kredi, apo kontrata kreditore, i referohemi të gjitha produkteve kreditore, përfshirë huatë, lizingun, kreditkartelat, mbitërheqjet, etj. Ndërsa me termin huamarrës, i referohemi fenomenit të përgjithshëm të huamarrjes (përfshirë të gjitha llojet e kredisë).

Mungesa e të dhënave të sakta mbi shumën e kështit të kredisë mund të shkaktojë devijim të rezultateve sepse normat e interesit ndryshojnë sipas institucionit, llojit dhe kushteve të kredisë, kështu që mund të ketë raste kur janë nënvlerësuar apo mbivlerësuar kështet që paguhen nga klientët. Gjithashtu, kështet mund të mos jenë të shpërndara në mënyrë të barabartë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, ku institucionet financiare mund të aplikojnë periudha të lirimit nga pagesa e kështit, apo të negociojnë pagesa të njëhershme të kredisë. Problemi kryesor qëndron në rastin e kreditkartelave, shuma e mbetur borxh e të cilave mund të jetë e strukturuar për pagesë në disa këste. Në këto raste, vlerësohet se niveli i ngarkesës me borxh kur janë të përfshira kreditkartelat, ka shkallë të lartë të dyshimit të saktësisë, përkatësisht probabilitet të lartë të mbivlerësimit. Edhe në rastin e mbitërheqjeve, supozimi i pagesës së gjithsej shumë të mbetur borxh vlerësohet se shkakton mbivlerësim të ngarkesës, ngase klientët në baza mujore zakonisht paguajnë vetëm interesin në shumën e shfrytëzuar të limitit të mbitërheqjes, ndërsa pagesa e shumë të plotë të mbitërheqjes kërkohet vetëm në mbyllje/maturim të kontratës.

### 3.4. Përkufizimi i ngarkesës me borxh

Në literaturën botërore, përkatësisht në studime të ndryshme për ngarkesën me borxh nuk ka konsensus sa i përket definicionit dhe mënyrës së vlerësimit të ngarkesës me borxh/mbingarkesës. Studiuesit nga shtete të ndryshme përdorin definicione, përkatësisht indikatorë të ndryshëm të vlerësimit të ngarkesës (D'Alessio & Iezzi, 2013). Ndër definicionet më të përdorura është ai në Mbretërinë e Bashkuar i cili fokusin e vendosë në borxhin e mbetur (vonesat) në pagimin e faturave të rregullta (përfshirë kështet kreditore), ku ngarkesa me borxh konsiderohet situata kur familjet ose individët janë në vonesë në bazë strukturore (vonesa të vazhdueshme për disa muaj), ose janë në rrezik të konsiderueshëm të hyjnë në kategorinë e vonesave strukturore (OXERA, 2004). Definicion tjetër më i përdorur është ai në Gjermani që me mbingarkesë nënkupton situatën kur të ardhurat e një familje, përkundër uljes së standardit jetësor, janë të pamjaftueshme për kryerjen e të gjitha obligimeve të pagesave për një periudhë më të gjatë kohore (Haas, 2006). Komisioni Evropian në vitin 2010 ka ritheksuar kriteret kryesore për vlerësimin e ngarkesës me borxh, të përcaktuara paraprakisht në vitin 2008 përmes një studimi për përcaktimin e një definicioni më gjithëpërfshirës dhe të përbashkët të ngarkesës me borxh për vendet e BE-së. Kriteret, të cilat duhet të plotësohen nga indikatorët e vlerësimit të nivelit të ngarkesës me borxh, përfshijnë: a) Ngarkesa me borxh duhet të vlerësohet në nivel të ekonomisë familjare dhe jo në nivel të individit, ngase ekonomitë familjare bashkojnë resurset – të hyrat dhe shpenzimet; b) Indikatorët duhet të përfshijnë të gjitha obligimet financiare, përfshirë të gjitha llojet e kontratave kreditore por edhe pagesave të faturave mujore të rregullta; c) Mbingarkesa nënkupton pamundësinë për të paguar shpenzime të përsëritshme (çdo muaj) andaj duhet të konsiderohet si problem i vazhdueshëm dhe jo i përkohshëm; ç) Problemi nuk mund të zgjidhet duke marrë më shumë borxh; dhe d) Problemi kërkon zvogëlim të dukshëm të shpenzimeve apo rritje të burimeve dhe nivelit të të hyrave.

D'Alessio & Iezzi (2013) sugjerojnë se studimet e fundit kanë treguar tendenca të përputhshmërisë drejt indikatorëve kryesorë për matjen e ngarkesës, gjithnjë duke theksuar mungesën e konsensusit për indikatorin më të 'mirë' të vlerësimit të mbi-ngarkesës. Indikatorët më të përdorur, të cilët respektojnë shumicën e parimeve të lartcekura, reflektojnë katër aspekte të ngarkesës si: pjesëmarrjen e lartë të borxhit në raport me të hyrat, vonesat në pagesë, përdorimin e shpeshtë të kredive dhe aspektin subjektiv të konsiderimit të borxhit si barrë e rëndë (Tabela 3). Autorët theksojnë se meqenëse indikatorët e lartcekur paraqesin aspekte të ndryshme të ngarkesës, secili prej tyre përbën informacion të rëndësishëm për vlerësim, por që asnjëri prej tyre nuk ka përparësi ndaj tjetrit. Për më tepër, Disney et al. (2008) argumentojnë se treguesit e ndryshëm kanë tendencë të vlerësojnë ngarkesën për grupe të ndryshme të ekonomive familjare, në faza të ndryshme të ciklit të jetës. Sfidat mbetet në gjetjen e kombinimit të treguesve që masin

ngarkesën për grupin e njëjtë të ekonomive familjare, sidomos për faktin e mungesës së të dhënave të disponueshme.

**Tabela 3. Treguesit e zakonshëm të ngarkesës me borxh**

Kategoria	Treguesi
Kosto e servisimit të borxhit: Borxhi ndaj të hyrave	Ekonomitë familjare që shpenzojnë më shumë se 30 % ( ose 50% ) të hyrave bruto mujore në pagesën e borxhit të siguruar dhe të pasiguruar
	Ekonomitë familjare që shpenzojnë më shumë se 25 % të hyrave mujore bruto në pagesën e borxhit të pasiguruar
	Ekonomitë familjare që pas pagesës së borxhit përfundojnë nën vijën e varfërisë
Vonesat	Ekonomitë familjare me vonesa më shumë se 2 muaj në pagesën e kontratave kreditore apo faturave shtëpiake
Numri i kontratave kreditore	Ekonomitë familjare me 4, apo më shumë se se 4 kontrata aktive kreditore
Perceptimi subjektiv i borxhit	Deklarimi i klientëve që obligimet e borxhit janë "barrë e rëndë" në të hyrat e tyre

Burimi: D'Allessio, G. and S. Iezzi, (2013) *Household Over-Indebtedness. Definition and Measurements with Italian Data*. Bank of Italy.

Në këtë studim, fillimisht tentohet që të bëhet vlerësim i ngarkesës me borxh të grupit të njëjtë të ekonomive familjare përmes treguesve që vlerësojnë të tri aspektet e para të ngarkesës. Por, në mungesë të informacionit të plotë për ekonominë familjare përmes kanalit të RKK-së dhe informatave të pranura nga institucionet financiare, vlerësimi do të jetë më objektiv për nivelin e ngarkesës së individëve.

Indikatori kryesor për matjen e nivelit të ngarkesës me borxh (**indeksi i ngarkesës me borxh**) është definuar si raporti ndërmjet **shumës së kësteve mujore të huave<sup>11</sup> dhe të hyrave mujore**. Indeksi është llogaritur gjithashtu edhe për të gjitha produktet kreditore, por nuk është analizuar ndërlidhja e tij me variablat tjera për shkak të kufizimeve të lartcekura në të dhëna dhe supozimeve konservative në kalkulimin e tij.

Indeksi i ngarkesës është llogaritur ndaras për huamarrësit individual dhe ekonomitë familjare respektive. Në rastin e individit, janë marrë për bazë të hyrat mujore të huamarrësit, përkatësisht të hyrat mujore neto nga tatimet dhe kontributet pensionale, ndërsa për ekonominë familjare është marrë për bazë buxheti i ekonomisë familjare (të hyrat e disponueshme të huamarrësit dhe anëtarëve tjerë të familjes). Në të dy rastet, borxhi paraqet vetëm borxhin e individit (të gjitha këstet mujore vetëm të huamarrësit, në mungesë të informacionit për borxhin e anëtarëve tjerë të familjes). Niveli i ngarkesës është ndarë në katër klasifikime, varësisht prej vlerës së indeksit.

- 1) **Të pangarkuar (indeksi i ngarkesës me borxh < 0.50):** huamarrësit/ekonomitë familjare të cilët shpenzojnë më pak se 50% së të hyrave mujore (neto vetëm nga tatimet), në pagesën e kësteve mujore të huave.
- 2) **Në rrezik (indeksi i ngarkesës me borxh = 0.50 – 0.75):** huamarrësit/ekonomitë familjare të cilët shpenzojnë 50% deri në 75% së të hyrave mujore në pagesën e kësteve mujore të huave.
- 3) **Në fazë kritike (indeksi i ngarkesës me borxh = 0.75 – 1.0):** huamarrësit/ekonomitë familjare të cilët shpenzojnë 75% deri në 100% së të hyrave mujore në pagesën e kësteve mujore të huave.

<sup>11</sup> Si indeks kryesor i ngarkesës është konsideruar indeksi i bazuar vetëm në këste të huave me pagesa të rregullta. Kjo për faktin se indeksi synon të vlerësojë ngarkesën mujore (borxhin mujor ndaj të hyrave mujore) dhe përfshirja e huave me këste të parregullta dhe produkteve kreditore si kreditkartelat dhe mbivlerësojnë nivelin e ngarkesës për shkak të mungesës së informacionit të saktë për këstet mujore.

- 4) **Jo-solvent (indeksi i ngarkesës me borxh > 1.0):** huamarrësit/ekonomitë familjare të cilët shpenzojnë gjithë të hyrat mujore në pagesën e kësteve mujore të huave; pra, këstet mujore tejkalojnë vlerën e të hyrave mujore.

Në rastin e ngarkesës së ekonomisë familjare, është llogaritur edhe **indeksi neto i ngarkesës**, i bazuar në të hyrat mujore të disponueshme, të zbritura edhe për shpenzimet e rregullta mujore të ekonomisë familjare (shpenzimet e jetesës, duke përfshirë pagesat e kësteve kreditore).

Niveli i ngarkesës me borxh sipas **indeksit neto** të ngarkesës për ekonomitë familjare është kategorizuar si në vijim:

- 1) **Të pa ngarkuar me borxh**, kur raporti i këstit ndaj të hyrave neto është nën 70 përqind;
- 2) **Të mbingarkuar**, kur indeksi i ngarkesës me borxh është në intervalin 70 -100 përqind;
- 3) **Jo-solvent**, kur indeksi tejkalon vlerën 100 përqind.

Duhet theksuar se indeksi neto është shfrytëzuar vetëm për vlerësimin e nivelit të ngarkesës në përgjithësi, duke mos analizuar ndërlidhjen e tij me faktorët e tjerë si në rastin e indeksit kryesor të ngarkesës.

Indekset e ngarkesës me borxh janë llogaritur me të dhëna për të hyrat si dhe këstet kreditore të cilat janë regjistruar në periudhën para shfaqjes së pandemisë COVID-19, si dhe me të dhëna të regjistruara pas shfaqjes së pandemisë (në gjysmën e parë të vitit 2021, kur edhe janë mbledhur informacionet për të hyrat) për të vlerësuar ndryshimin eventual të të hyrave dhe borxhit, përkatësisht ngarkesës me borxh, para dhe pas periudhës së shfaqjes së pandemisë.

Vlerësimi i ngarkesës sipas aspektit të vonesave dhe numrit të kontratave kreditore është bërë vetëm në nivel të huamarrësit/individit, përmes treguesit të vonesave më shumë se 2 mujore në pagesën e kontratave kreditore si dhe numrit të kontratave kreditore të huamarrësve. Këta dy tregues nuk janë të ndikuar nga kufizimet e lartcekura në të dhëna,<sup>12</sup> andaj në kombinim me indeksin kryesor të ngarkesës me borxh paraqesin burim objektiv të informimit mbi nivelin e ngarkesës me borxh të huamarrësve.

Për shkak të kufizimit në të dhëna për njësinë e ekonomisë familjare për vlerësimin e ngarkesës në kuadër të kornizës së këtij studimi, si vlerësim shtesë është porositur realizimi i anketimit të ekonomive familjare.

Pyetjet e parashtruara përmes anketës janë:

- 1) Çfarë përqindje të të hyrave mujore familjare i shpenzoni në pagesën e kredisë/kredive?
- 2) Sa shpesh ju ndodh të keni vonesa më të gjata se 2 muaj në pagesën e shpenzimeve komunale (uji, energjia elektrike, mbeturinat, tatimi në pronë)?
- 3) Si ka ndikuar kriza pandemike tek të ardhurat tuaja familjare?
- 4) Çfarë përqindje të të hyrave mujore familjare i shpenzoni në konsum (ushqim, higjiene, rroba) dhe shpenzime komunale (uji, energjia elektrike, mbeturinat, tatimi në pronë)?
- 5) Cilat janë pritjet për të ardhurat tuaja familjare në 3 muajt e ardhshëm?

<sup>12</sup> Vonesat në pagesë dhe numri i kontratave kreditore janë variabla mirë të definuara që nuk lënë hapësirë për subjektivitet, mos-konsistencë dhe probleme tjera të mundshme të theksuara në lidhje me indeksin e ngarkesës me borxh.

### 3.5. Përpunimi i të dhënave

Përpunimi i të dhënave të studimit dhe nxjerrja e rezultateve është bërë me programin për statistikë dhe analizë të të dhënave – STATA 15.1


Relacioni mes variablave është vlerësuar duke përdorur testet si Pearson's  $\chi^2$  si dhe t-testin. Duke marrë parasysh që analiza bëhet në një mostër të klientëve, rezultatet janë testuar për rëndësinë e tyre statistikore. Pothuajse në të gjitha rastet janë interpretuar vetëm rezultatet që kanë rëndësi statistikore në nivelin 1 dhe 5 % (kur vlera  $p \leq 0.05$ ). Duhet theksuar se rëndësia statistike e rezultateve në rastet kur ka lidhshmëri në mes të dy variablave nuk paraqet domosdoshmërisht ndërlidhje shkak-pasojë.

## 4. Rezultatet

### 4.1. Karakteristikat socio-demografike dhe socio-ekonomike të huamarrësve


Shumica e huamarrësve të mostrës së përzgjedhur, respektivisht 71.0 përqind janë burra, në grupmoshën 30-40 vite. Mbi 70 përqind e gjithsej huamarrësve janë të martuar (Tabela 4).

Grafiku 1. Lloji i vendbanimit



Burimi: BQK.

Grafiku 2. Pjesëmarrja e huamarrësve sipas rajoneve




Burimi: BQK.

Rreth 55 përqind e huamarrësve banojnë në vendbanime urbane (Grafiku 1). Më shumë se një e treta janë nga rajoni i Prishtinës, ndërsa rajoni me numrin më të vogël të huamarrësve është Ferizaj (Grafiku 2).

Afër një e treta e huamarrësve kategorizohen si Profesionistë<sup>13</sup>, sipas Standardit Ndërkombëtar për Klasifikimin e Profesioneve (SNKP) (Grafiku 3). Shumica e huamarrësve kanë deklaruar mbi 10 vite përvojë pune. Ekonomitë familjare me dy të punësuar kanë pjesëmarrjen më të lartë në mostrën e përzgjedhur të huamarrësve, pasuar nga ekonomitë familjare me vetëm një të punësuar që përbejnë pothuajse një të tretën e mostrës.

Grafiku 3. Shpërndarja e huamarrësve sipas profesionit



Burimi: BQK.

<sup>13</sup> Profesionistët e shkencës dhe inxhinierisë; Profesionistët e shëndetit; Profesionistët e mësimdhënies; Profesionistët e biznesit dhe administratës; Profesionistët e teknologjisë së informimit dhe komunikimit; Profesionistët ligjor, shoqëror dhe kulturor [Klasifikimi i profesioneve në Kosovë - ISCO KS \(rks-gov.net\)](#)

Tabela 4. Karakteristikat socio-demografike të huamarrësve


Karakteristikat	Pjesëmarrja (%)	Numri/ Frekuenca
<b>Mosha</b>		
< 30 vjet	17.33	341
30 - 40 vjet	29.32	577
40 - 50 vjet	24.49	482
50- 60 vjet	20.17	397
> 60 vjet	8.69	171
<b>Gjinia</b>		
Burrë	70.75	1405
Grua	29.25	581
<b>Statusi</b>		
E/I Pamartuar	28.19	548
E/I Martuar	71.19	1384
E/I Ndare	0.62	12
<b>Përvoja në punë</b>		
0-5 vite përvojë pune	27.01	437
6-10 vite	27.13	439
mbi 10 vite	45.86	742
<b>Numri i të punësuarve në ekonomitë përkatëse</b>		
1 (vetëm huamarrësi)	34.31	586
2 të punësuar	42.86	732
3-5 të punësuar	20.37	348
mbi 5 të punësuar	2.46	42

Burimi: BQK.

#### 4.1.1 Të hyrat mujore të huamarrësve

Të hyrat mesatare të huamarrësve<sup>14</sup> ishin 643 euro në muaj. Mediana e të hyrave ishte 505 euro, që sugjeron se gjysma e klientëve kishin të ardhura neto nën 505 euro në muaj (Grafiku 4). Janë vërejtur dallime të theksueshme në të hyra sipas disa karakteristikave socio-demografike. Të hyrat mujore për huamarrëset gra, në mesatare, ishin për 151 euro më të ulëta. Huamarrësit me vendbanim në vende urbane kishin të hyra, në mesatare, më të larta për 120 euro se

Grafiku 4. Të hyrat mujore të huamarrësve



Burimi: BQK.

huamarrësit në vende rurale. Sa i përket ndarjes sipas rajoneve, të hyrat në rajonin e Prishtinës ishin më të larta, por, dallimet nuk ishin statistikisht të rëndësishme.

Dallime të rëndësishme, konform pritjeve, kishte ndërmjet grupeve të moshave të ndryshme, profesioneve, si dhe përvojës së punës së huamarrësve. Grup moshë më e re se 30 vite si dhe ajo më e moshuar se 60 vite kanë, në mesatare, kishin të hyra më të ulëta. Grup moshë 41-50 vjet kishin të hyrat më të larta. Profesionet me nivel më të lartë të aftësive të kërkuara kishin pagë

<sup>14</sup> Të hyrat mujore përfshijnë të hyrat mujore pas tatimeve.

mujore më të lartë. Dallimet janë statistikisht të rëndësishme vetëm ndërmjet grupit të menaxherëve dhe pothuajse të gjitha profesioneve tjera, si dhe profesionistëve dhe punonjësve të zejes dhe profesioneve elementare. Sipas përvojës së punës, të hyrat janë më të larta në grupet e klientëve me përvojë më të lartë të punës (Shtojca 1).

Të hyrat mujore mesatare nuk kishin dallime të rëndësishme në mes të grupit të klientëve të bankave dhe atyre të institucioneve mikrofinanciare. Megjithatë, dallimet theksohen në krahasime individuale


ndërmjet institucioneve, veçanërisht për tri institucione (dy banka dhe një mikrofinancë), të cilat në mesatare kanë të hyrat më të larta. Arsyeja mund të ndërlidhet me strategjinë specifike të këtyre institucioneve në kreditimin e klientëve në shumë më të lartë, e që respektivisht korrespondon me të hyra më të larta. Kjo mbështetet gjithashtu me faktin që, mesatarisht, klientët e dy prej këtyre institucioneve kanë rezultuar të kenë vlerë më të lartë të kredive aktive në kohën e disbursimit. Marrë parasysh rrethanat pandemike dhe ndikimin e tyre në gjendjen e përgjithshme ekonomike, studimi ka tentuar të masë efektin e mundshëm të pandemisë COVID-19 në të hyrat e huamarrësve. Mesatarja e të hyrave mujore të huamarrësve, për dallim nga pritjet e përgjithshme, rezulton më e lartë pas pandemisë COVID-19. Ky rezultat ndikohet kryesisht nga të hyrat e huamarrësve të dy institucioneve bankare, të cilët në mesatare, kanë të hyra më të larta pas pandemisë. Sipas profesioneve, janë punëtorët e aftësuar në bujqësi, pylltari dhe peshkatari, punonjësit e shërbimit dhe shitjes; operatorët dhe instaluesit në fabrika dhe makina, si dhe profesionet elementare që rezultojnë me rënie të hyrave pas pandemisë COVID-19, përderisa profesionet tjera rezultojnë me rritje.

Devijimi standard i të hyrave pas pandemisë është më i lartë, gjë që sugjeron se rezultati është ndikuar më shumë nga observime më ekstreme. Sidoqoftë, ndryshimi i të hyrave të huamarrësve para dhe pas pandemisë COVID-19 nuk mund të konsiderohet se reflekton tërësisht ndikimin e pandemisë për shkak se të dhënat para pandemisë në shumë raste janë regjistruar në kohën e lëshimit të kredisë nga institucionet, dhe ndryshimet eventuale në të hyrat e huamarrësve prej kohës së lëshimit të kredisë deri në kohën e marrjes së të dhënave për qëllime të këtij studimi, nuk janë reflektuar në të gjitha rastet. Andaj, ndryshimi, në këtë rast rritja, mund të reflektojë gjithashtu rritjen graduale së të hyrave të huamarrësve, pavarësisht efektit të pandemisë.

#### 4.1.2 Të hyrat mujore të ekonomive familjare

Ekonomitë familjare, në mesatare, kishin të hyra mujore prej 1,084 euro. Mediana e të hyrave mujore ishte më e ulët, përkatësisht 830.5 euro. Të hyrat në ekonomitë familjare me më shumë anëtarë të punësuar ishin më të mëdha, por dallimet përgjithësisht bien me rritjen e numrit të të punësuarve. Mesatarisht, të hyrat rriten për 350 euro me rritjen e numrit të një të punësuar, deri në katër të punësuar. Në familjet me pesë ose më shumë të punësuar, të cilat kanë pjesëmarrje të ulët në gjithsej mostrën e studimit, të hyrat tregojnë ndryshueshmëri (variancë) më të lartë dhe nuk rriten tutje.

Grafiku 5. Shpenzimet dhe të hyrat neto mujore të ekonomive familjare



Burimi: BQK.



Dallimet në të hyrat mesatare të ekonomive familjare sipas karakteristikave demografike rezultojnë të ngjashme me dallimet që janë paraqitur tek të hyrat e huamarrësve, me disa përjashtime. Ekonomitë familjare ku huamarrësi është femër rezultojnë të kenë 122.3 euro më pak të hyra mujore se tek ekonomitë familjare ku huamarrësi është mashkull. Ekonomitë familjare në rajonin e Prishtinës kanë të hyrat familjare më të larta, ndërsa ato të rajonit të Gjilanit të hyrat më të ulëta. Të hyrat e ekonomive familje në vende urbane janë më të larta se në vendet rurale.

Për dallim nga të hyrat e huamarrësve individual të cilat ishin të ngjashme sipas llojit të institucionit (bankë apo mikrofinancë), të hyrat e ekonomive familjare të huamarrësve të sektorit bankar, në mesatare, rezultuan më të larta se të huamarrësve të sektorit mikrofinanciar.

Për dallim nga të hyrat e huamarrësve individual të cilat u rritën pas periudhës pandemike, të hyrat e ekonomive familjare, në mesatare, kanë rënë pas pandemisë COVID-19 për 87.5 euro, në vlerën 978.8 euro. Mediana e të hyrave për ekonomi familjare pas COVID-19 është 735 euro. Këto rezultate sugjerojnë që rënia e buxhetit të ekonomive familjare të huamarrësve është ndikuar nga rënia e të hyrave të anëtarëve tjerë të familjes së huamarrësve. Rënia e të hyrave të ekonomive familjare ndikohet kryesisht nga të hyrat e ekonomive familjare të klientëve të institucioneve mikrofinanciare, që në mesatare kanë pësuar rënie më të theksuar gjatë pandemisë (Tabela 5).

**Tabela 5. Statistikat përshkruese së të hyrave neto të ekonomive familjare**

Karakteristikat socio-demografike të ekonomive familjare	Para Covid-19		Pas Covid-19	
	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana
Burrë	1102	802	1002	720
Grua	980	800	924	758
E/l pamartuar	1077	800	1022	760
Martuar	1061	800	955	728
I/e ndarë	1741	1040	1828	859
Urban	1174	900	1092	800
Rural	931	736	835	650
Ferizaj	931	800	796	693
Gjakovë	970	770	879	700
Gjilan	818	730	767	672
Mitrovicë	975	700	872	644
Pejë	1021	800	910	641
Prishtinë	1240	940	1177	840
Prizren	1045	810	940	700
Forcat e armatosura	754	700	734	700
Menaxherët	1687	1000	1563	800
Profesionistët	1302	1000	1218	950
Teknikët dhe bashkëpunëtorët profesional	1106	893	1063	785
Punëtorë zyreje dhe asistent	858	650	774	500
Punonjësit e shërbimit dhe shitjes	922	797	813	666
Punëtorët e aftësuar në bujqësi, pylltari dhe peshkatari	945	820	809	700
Punonjësit e zejes dhe profesioneve të ngjashme	899	720	776	680
Operatorët dhe instaluesit në fabrika dhe makina	810	700	827	700
Profesionet elementare	862	673	775	620
Pensioner	617	570	574	470
Shtëpiake	864	800	699	500
Tjera, përfshirë mirëqenien sociale	1267	681	1270	678
Student	955	926	787	699
< 30 vjet	984	800	931	750
30 - 40 vjet	1150	868	1048	770
40 - 50 vjet	1131	795	1042	700
50- 60 vjet	981	797	864	700
> 60 vjet	952	765	917	700
1 (vetëm huamarrësi)	750	591	693	536
2 të punësuar	1117	900	1006	800
3-5 të punësuar	1524	1257	1384	1051
mbi 5 të punësuar	1607	1300	1335	1066
Bankë	1097	800	1035	750
Mikrofinancë	991	808	849	700

Burimi: BQK.

### 4.1.3 Shpenzimet mujore të ekonomive familjare

Shpenzimet e rregullta mujore të ekonomive familjare (pagesat e faturave mujore të energjisë, ujit, mbeturinave, shërbimeve komunale dhe të internetit – utilities, si dhe shpenzimet tjera të jetesës, duke mos përfshirë këstet kreditore) në mesatare rezultojnë 417.2 euro. Mediana e shpenzimeve mujore është më e ulët, përkatësisht 320 euro (Grafiku 5). Shpenzimet, ashtu sikurse të hyrat, janë më të larta në rajonin e Prishtinës dhe më të ulëtat në rajonin e Gjilanit. Shpenzimet e ekonomive familjare në vendbanimet urbane janë më të larta. Ekonomitë familjare të huamarrësve të sektorit bankar kanë shpenzime, në mesatare, më të larta se huamarrësit në sektorin mikrofinanciar. Shpenzimet rezultojnë më të larta në ekonomitë familjare të huamarrësve të martuar. Ngjashëm me të hyrat, shpenzimet rriten me rritjen e numrit të anëtarëve të punësuar të familjes. Por, tek shpenzimet, rritja është më e larta nga grupi me një anëtar të punësuar në dy anëtarë të punësuar, 132 euro në mesatare, dhe kjo rritje ngushtohet me rritjen e numrit të anëtarëve të punësuar.

Të hyrat mujore neto të ekonomive familjare (pas zbritjes së shpenzimeve të raportuara) rezultojnë, në mesatare, 640.0 euro.

Shpenzimet mujore të ekonomive familjare pas pandemisë COVID-19 shënuan rritje për mesatarisht 33.8 euro. Rrjedhimisht, të hyrat neto të ekonomive familjare pas pandemisë shënuan rënie për 107.6 euro, e cila u ndikua si nga rënia e të hyrave, ashtu edhe nga rritja e shpenzimeve (Shtojca 2).

## 4.2. Modelet e huamarrjes

### 4.2.1 Lloji i kredisë


Gjysma e kontratave aktive kreditore të huamarrësve ishin hua (50.4 përqind), pasuar nga mbitërheqjet dhe kreditkartelat të cilat përfaqësuan 19 përqind, respektivisht 30 përqind të kontratave aktive. Llojet e tjera të kontratave kreditore<sup>15</sup> përbënin vetëm 0.6 përqind të gjithëj portofolit kreditor (Grafiku 6).

Shpërndarja e lartcekur e kontratave kreditore me dominim të huave ndikohet nga sektori mikrofinanciar, i cili operon pothuajse vetëm me hua (99.6 përqind të kontratave aktive në sektorin mikrofinanciar janë kredi dhe vetëm 0.6 përqind lizing financiar). Ndërsa, në kuadër të sektorit bankar shpërndarja e kontratave kreditore sipas produktit kreditor është më e barabartë (Grafiku 7). Kjo shpërndarje ka dallime të theksueshme brenda institucioneve të sektorit bankar, gjë që reflekton strategjitë e ndryshme të bankave për fokusim në produkte të caktuara kreditore.


Përdorimi i produkteve të ndryshme kreditore rezulton me dallime statistikisht të rëndësishme sipas karakteristikave socio-demografike. Kreditkartelat përdoren në përqindje më të lartë në vendbanime urbane, ku 71.6 përqind e huamarrësve urban janë përdorues të tyre kundrejt 50.7 përqind të huamarrësve në vende rurale. Pjesëmarrje më të lartë të përdoruesve të kreditkartelave kishte rajoni i Prishtinës, 73 përqind të huamarrësve për dallim nga mesatarja prej 63.6 përqind e të gjitha rajoneve.

<sup>15</sup> Në Regjistrin e Kredive të Kosovës, llojet e kredive kategorizohen si në vijim: 1) kreditë; 2) mbitërheqjet; 3) kreditkartelat; 4) asete të tjera kreditore; 5) letrat e kreditit; 6) garancionet; dhe 7) lizingu. Për qëllime të lehtësisimit të analizës, katër kategoritë e fundit janë grupuar në një kategori të cilës i referohemi me lloje të tjera të kontratave kreditore.

Grafiku 6. Shpërndarja e kontratave aktive sipas produktit kreditor



Grafiku 7. Shpërndarja e kontratave aktive sipas produktit kreditor, sektori bankar



Ferizaj ishte rajoni me numrin më të ulët të përdoruesve. Huamarrësit në grup moshën 31-40 vjet ishin përdorues më të shpeshtë të kreditkartelës, ndërsa përdoruesit më të rrallë ishin grup-mosha mbi 60 vjet si dhe deri në 30 vjet. Gratë rezultuan përdoruese më të mëdha të kreditkartelave, ku 49.9 përqind e grave kishin bilanc pozitiv në kreditkartelë krahasuar me 44.8 përqind të burrave. Sipas profesionit, përdorues më të shpeshtë kryesisht ishin profesionet me kualifikime më të larta si profesionistët, teknikët dhe bashkëpunëtorët profesional, por edhe profesionet e forcave të armatosura dhe studentët. Kreditkartelat përdorshin më shumë në ekonomitë familjare me dy të punësuar, ndërsa më pak në ato me vetëm një të punësuar dhe me më shumë se katër të punësuar. Huamarrësit me kontrata kreditore në më shumë se një institucion financiar ishin përdorues më të mëdhenj të kreditkartelave. Tendenca pak më të mëdha të përdorimit të kreditkartelave kishin huamarrësit që nuk posedonin hua aktive. Ndërsa, tendencat e përdorimit të kreditkartelave ishin shumë më të mëdha te huamarrësit që përdornin mbitërheqje.

Përdorues më të shpeshtë të kreditkartelave ishin huamarrësit që kishin hua aktive të ristrukturuar (74.3 përqind në krahasim me 62.1 përqind të huamarrësve pa kredi të ristrukturuara).

Mbitërheqjet rezultuan të kenë tendencë të përdorimit më të shpeshtë nga huamarrësit që kanë edhe hua, nga të cilët 49.0 përqind përdorin po ashtu mbitërheqje për dallim nga 39.2 përqind e përdoruesve të mbitërheqjeve që nuk posedojnë hua. Tendencë shumë më të lartë të përdorimit të mbitërheqjeve kanë shfaqur huamarrësit që kishin edhe kreditkartelë (69.0 përqind krahasuar me 11.9 përqind jo-përdorues të kreditkartelave).

Rrjedhimisht, huamarrësit me më shumë se një kontratë kreditore, përkatësisht tri e më shumë, ishin përdorues më të mëdhenj të mbitërheqjeve. Tendencat e përdorimit të mbitërheqjeve ishin më të larta për klientët me kontrata aktive nga një institucion i vetëm (50.2 përqind krahasuar me 44.1 përqind për klientët me kontrata aktive nga institucione të ndryshme), gjë që sugjeron se klientët preferojnë të përdorin mbitërheqje në të njëjtën bankë ku kanë kontratë tjetër kreditore (përkatësisht hua apo kreditkartelë). Edhe tek mbitërheqjet, përdoruesit më të shpeshtë, me borxh aktiv në mbitërheqje, ishin ata me kredi aktive të ristrukturuara (25.7 përqind në krahasim me 16.2 përqind të huamarrësve pa kredi të ristrukturuara).

Përdorimi i mbitërheqjeve gjithashtu shfaq dallime statistikisht të rëndësishme sipas disa karakteristikave socio-demografike. Mbitërheqjet përdoren në nivel më të lartë nga huamarrësit në vendbanime urbane, në përbërje prej 56.2 përqind krahasuar me 36.5 përqind të përdoruesve që vijnë nga vendet rurale. Përdorues më të shpeshtë të mbitërheqjeve janë huamarrësit nga rajoni i Prishtinës, 55.6 përqind e të cilëve ishin përdorues për dallim nga mesatarja prej 48.3 përqind e të gjitha rajoneve. Ferizaj ishte rajoni me numrin më të ulët të shfrytëzuesve, ngjashëm si për kreditkartelat.


Huamarrësit në grup moshën 31-40 vjet dhe 51-60 vjet ishin përdorues më të shpeshtë të mbitërheqjeve, ndërsa përdoruesit më të rrallë ishin personat në grup moshë mbi 60 vjet si dhe deri në 30 vjet. Sipas profesionit, përdorues më të shpeshtë ishin profesionet me kualifikime më të larta si profesionistët, teknikët dhe bashkëpunëtorët profesional, dhe profesionet e forcave të armatosura.

Mbitërheqjet shfrytëzoheshin më shumë në ekonomitë familjare me dy dhe katër të punësuar, përderisa përdoruesit më të rrallë në krahasim me grupet tjera ishin ekonomitë familjare me mbi pesë të punësuar.


Shpërndarja e llojeve të kredive sipas vlerës së aprovuar të kontratave aktive kreditore të huamarrësve të përfshirë në mostër dominohet nga huatë, me 86.2 përqind pjesëmarrje në gjithsej portfolion kreditore (Grafiku 8). Mbitërheqjet dhe kreditkartelat, megjithëse në numër të shumtë, përbënin vetëm 1.8 përqind, respektivisht

4.2 përqind të vlerës së gjithsej portfolit kreditor, gjë që sugjeron për shumën mesatare të ulët të këtyre produkteve kreditore. Ndërsa, kreditë hipotekare, përkundër numrit të vogël, kishin pjesëmarrje prej 7.0 përqind në gjithsej vlerën e aprovuar të portfolit kreditor për shkak të shumës së aprovuar shumë më të lartë se kategoritë e tjera të kredive. Vlera e mbetur e produkteve kreditore aktive kishte shpërndarje të ngjashme me vlerën e aprovuar (Grafik 9).

Grafiku 8. Shpërndarja e vlerës së aprovuar të kredive aktive sipas llojit të kredisë (si % ndaj gjithsej shumës)




Grafiku 9. Shpërndarja e vlerës së mbetur të kredive aktive sipas llojit të kredisë (si % ndaj gjithsej shumës)



#### 4.2.2 Vlera mesatare e kredisë

Mesatarja e shumës së aprovuar të gjithsej kredisë ishte 5.4 mijë euro, me vlerë maksimale të aprovuar prej 562.5 mijë euro (Grafiku 10). Huatë, si produkti kryesor, kishin vlerë mesatare të shumës së aprovuar prej 9.2 mijë euro (Tabela 6). Sidoqoftë, kishte dallime të mëdha ndërmjet shumës së huave ku vlera maksimale arrinte deri në 364.5 mijë euro. Gjysma e huave aktive kishin vlerën e aprovuar prej 5.0 mijë euro. Mesatarja e shumës së mbetur për pagesë të huave aktive, në muajin mars 2021, ishte afër 6.2 mijë euro (Tabela 7).

Grafiku 10. Mesatarja e shumës së aprovuar dhe të mbetur borxh, sipas llojit të kredisë



Burimi: BQK.

Mesatarja e shumës së aprovuar të huave të sektorit bankar ishte më e lartë, 13.4 mijë euro, krahasuar me mesataren prej 2.6 mijë euro në sektorin mikrofinanciar. Dallime të theksueshme në shumën mesatare të huave kishte edhe brenda institucioneve të grupit bankar, me ç'rast bankat më të mëdha në treg kanë mesatare më të lartë të shumës së aprovuar të huave, megjithëse janë edhe dy banka më të vogla që kanë numër të vogël të klientëve por me shuma të larta. Ngjashëm, dallime kishte edhe brenda institucioneve mikrofinanciare, që reflekton strategjitë e ndryshme të kreditimit të institucioneve.

Mbitërheqjet dhe kreditkartelat kishin vlerë mesatare të ulët: gjysma e tyre kishin vlerë më të ulët se 400, respektivisht 500 euro (Tabela 6). Mesatarja e vlerës së mbetur për pagesë të mbitërheqjeve ishte 120 euro, ndërsa për kreditkartela 316 euro (Tabela 7). Dallimet ndërmjet institucioneve në mesataren e vlerës së aprovuar të këtyre dy produkteve ishin statistikisht të rëndësishme. Në rastin e mbitërheqjeve, dy nga bankat kishin mesatare më të lartë, sidomos në krahasim me bankën me mesataren më të ulët. Tek kreditkartelat, mesatarja e njëres bankë ishte theksueshëm më e lartë se pjesës tjetër të bankave.

Tabela 6. Statistikat përshkruese të shumës së aprovuar të kontratave kreditore aktive (në euro)

Produktet kreditore	Mesatarja	Mediana	Minimumi	Maksimumi
Hua	9,180	5,000	18	364,500
Mbitërheqje	500	400	-	5,200
Kredit Kartelë	769	500	100	12,000
Lizingu financiar	28,433	26,952	6,000	50,000
Kreditë hipotekare	78,230	53,000	577	562,500
<b>Total</b>	<b>5,363</b>	<b>1,000</b>	<b>-</b>	<b>562,500</b>

Burimi: BQK.

Kontratat e tjera kreditore si kreditë hipotekare dhe lizingu financiar, megjithëse më të pakta në numër (24 dhe 6 observime respektivisht), kishin vlerën më të lartë në mesatare të aprovuar si dhe atë të mbetur për pagesë (Tabela 6 dhe 7). Te kreditë hipotekare, mesatarja e shumës së aprovuar ndikohet nga vetëm njëri institucion bankar që ka vlerë mesatare më të lartë.

**Tabela 7. Statistikat përshkruese të shumës së mbetur të kredive aktive (në euro)**

Produktet kreditore	Mesatarja	Mediana	Minimumi	Maksimumi
Hua	6,228	2,490	-	356,339
Mbitërheqje	120	-	-	4,065
Kredit Kartelë	316	143	-	9,921
Lizingu financiar	20,869	21,469	4,215	43,925
Kreditë hipotekare	52,533	40,884	530	279,593
<b>Total</b>	<b>3,534</b>	<b>498</b>	<b>-</b>	<b>356,339</b>

Burimi: BQK.

**4.2.3 Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja mesatare e të gjitha kontratave kreditore aktive ishte 5 vite e 5 muaj. Kreditë hipotekare, në mesatare, kishin afatin më të gjatë prej 12 vite e 3 muaj, pasuar nga lizingu financiar prej 11 vite e 8 muaj. Mbitërheqjet në mesatare kishin afat maturimi prej 7 vite e 6 muaj, ndërsa kreditkartelat 6 vite e 4 muaj (Tabela 8).

**Tabela 8. Kohëzgjatja e kredive aktive (në vite)**


Përshkrimi	Mesatarja	Mediana	Maksimumi	Minimumi
<b>Hua</b>	4.2	3.0	25.0	0.1
Bankë	5.5	5.0	25.0	0.8
Mikrofinancë	2.1	2.0	5.3	0.1
<b>Mbitërheqje</b>				
Bankë	7.6	6.0	22.4	0.5
<b>Kredit Kartelë</b>				
Bankë	6.4	5.0	16.5	1.3
<b>Lizingu financiar</b>				
Mikrofinancë	11.8	11.1	20.2	3.2
<b>Kredi hipotekare</b>				
Bankë	12.3	11.3	25.3	5.2
<b>Gjithsej</b>	5.5	4.9	25.3	0.1
Bankë	6.4	5.0	25.3	0.5
Mikrofinancë	2.1	2.0	20.2	0.1

Burimi: BQK.

Huatë, në mesatare kishin kohëzgjatjen më të shkurtër prej 4 vite e 2 muaj, por me dallime të theksuara brenda kategorisë ku minimumi i kohëzgjatjes është 1 muaj ndërsa maksimumi 25 vite. Kohëzgjatja mesatare e huave të sektorit bankar ishte më e lartë, 5 vite e 5 muaj, krahasuar me atë në sektorin mikrofinanciar prej 2 vite e 1 muaj.


Nga gjithsej 5,014 kontrata aktive, afër gjysma e tyre ishin të aprovuara në vitin 2019 dhe 2020. Në vitin 2021 janë lëshuar 8 përqind e kontratave kreditore (Grafiku 11). Pjesa më e madhe e kontratave nuk e kanë kaluar gjysmën e kohës së maturimit, që do të thotë se janë në fazën e parë dhe të dytë të pagesës (Grafiku 12).

Grafiku 11. Shpërndarja e kredive aktive sipas vitit të aprovimit të kredisë (në % të kontratave kreditore)



Burimi: BQK.

Grafiku 12. Shpërndarja e kredive aktive sipas periudhës së maturimit




Burimi: BQK.

#### 4.2.4 Qëllimi i kredisë

Kontratave aktive kreditore, në shumicën e rasteve, përkatësisht në 51.9 përqind të rasteve, nuk kishin qëllim të specifikuar (Grafiku 13).

Grafiku 13. Shpërndarja e kontratave aktive kreditore sipas qëllimit dhe institucioneve financiare (% e kredive ndaj kredive të institucioneve përkatëse)



Burimi: BQK.

Kjo dukuri ishte veçanërisht e shprehur në sektorin bankar, ku 63.5 përqind e kredive të lëshuara nuk kishin qëllim të specifikuar krahasuar me vetëm 6.0 përqind në sektorin mikrofinanciar. Diferenca ndërmjet sektorëve shpjegohet nga pjesëmarrja e lartë në sektorin bankar e produkteve si kreditkartelat dhe mbitërheqjet, të cilat kanë shuma të vogla dhe qëllimi i përdorimit zakonisht nuk është specifikuar: në 76.6 përqind të rasteve të përdorimit të kreditkartelave dhe 70.2 përqind të mbitërheqjeve nuk është specifikuar qëllimi (Grafiku 14).


Dallimet në shpërndarjen e kredive sipas qëllimit janë të theksuara edhe brenda institucioneve bankare, të ndikuara gjithashtu nga raporti i pjesëmarrjes së produkteve kreditore, ku nga gjithsej kreditë pa qëllim të specifikuar, 80.7 përqind e kredive janë të lëshuara nga vetëm njëra bankë.

Në rast të mos përfshirjes së kreditkartelave dhe mbitërheqjeve, pjesëmarrja e kredive për qëllime të tjera në gjithsej kontratat kreditore aktive bie nga 51.9 përqind në 30.9 përqind. Kontratat kreditore për qëllime konsumi kishin pjesëmarrjen më të lartë të radhës prej 28.8 përqind, rezultat ky gjithashtu i ndikuar nga pjesëmarrja e lartë e kreditkartelave dhe mbitërheqjeve të cilat kryesisht përdoren për qëllime konsumi.

Shumat më të larta të aprovuara dhe të mbetura borxh janë tek kreditë për qëllime ndërtimi dhe banimi, për shkak të vlerës më të lartë mesatare dhe maturitetit më të gjatë të këtyre kredive (në mesatare kjo kategori ka maturitet 10 vite krahasuar me mesataren 5.5 vite së të gjitha kontratave kreditore). Ndërsa, kreditë konsumuese, në mesatare, kanë shumën më të ulët të aprovuar, 3.9 mijë euro. Kreditë e aprovuara për qëllime të tjera, të cilat në numër janë pothuaj dyfishi i kredive konsumuese, kishin shumë mesatare të aprovuar të përafërt, 3.8 mijë euro.


Në grafikun 15 janë paraqitur qëllimet e kredisë sipas llojit të institucionit financiar në bazë të shumës së mbetur borxh, me ç'rast shihet që në mesatare bankat përbëjnë pjesën më të madhe të pothuajse secilës kategori.

Grafiku 14. Shpërndarja e kontratave aktive kreditore sipas produkteve kreditore dhe sipas qëllimeve të tyre



Burimi: BQK.

Grafiku 15. Shuma e mbetur borxh, në mesatare, sipas qëllimit të kredisë dhe sipas institucioneve



Burimi: BQK.



#### 4.2.5 Kolaterali


Më pak se një e treta (31.9 përqind) e kontratave aktive kreditore janë të kolateralizuara me kolateral vetanë të huamarrësve.<sup>16</sup> Shkalla e kolateralizimit për të gjitha kontratat kreditore rezulton më e lartë në sektorin mikrofinanciar, 47.8 përqind në krahasim me 27.9 përqind në sektorin bankar. Kjo për faktin se në sektorin bankar janë të përfshira kreditkartelat, të cilat janë të shumta në numër si dhe janë produkt kreditor i pakolateralizuar (Grafiku 16).

Kreditë hipotekare dhe lizingu financiar, të cilat janë produkte kreditore të mbështetura me kolateral (vlera e asetit të blerë shërben si kolateral), rezultojnë pothuajse plotësisht të kolateralizuara. Më shumë se gjysma e huave janë të kolateralizuara, ndërsa mbitërheqjet kanë shkallë relativisht të ulët kolateralizimi prej 14 përqind. Analizuar sipas qëllimit, kontratat kreditore për automjete, ato për tokë dhe ndërtesë dhe ato për asete fikse ishin më së shpeshti të kolateralizuara. Kreditë konsumuese kishin shkallë kolateralizimi prej 43.5 përqind. (Grafiku 17).

Kontratat kreditore të


kolateralizuara kishin vlerë mesatare dukshëm më të lartë, përkatësisht 12 mijë euro krahasuar me vlerën 2.2 mijë euro të kontratave të pakolateralizuara. Dallimet në vlerë ishin më të theksueshme brenda kontratave të pakolateralizuara, gjysma e të cilave ishin nën shumën 600 euro. Sektori bankar, përkundër shkallës më të ulët të kolateralizimit të kredive, ka vlerë të ulët të mesatare së kredive të pakolateralizuara, gjysma e të cilave është nën vlerën 500 euro (Tabela 9).

Grafiku 16. Shpërndarja e kredive aktive sipas llojit të kredisë dhe kolateralit



Burimi: BQK.

Grafiku 17. Shpërndarja e kredive aktive sipas qëllimit të kredisë dhe kolateralit



Burimi: BQK.

<sup>16</sup> Informacioni mbi kolateralin apo format e tjera të garancionit, që të tjerët mund të kenë vënë në dispozicion për këto kontrata kreditore të huamarrësve mostër nuk ishte i disponueshëm.

**Tabela 9. Vlera e aprovuar e kontratave kreditore aktive sipas kolateralizimit dhe sektorit, në euro**

Përshkrimi	Total		Bankë		Mikrofinancë	
	Të kolateralizuara	Të pa kolateralizuara	Të kolateralizuara	Të pa kolateralizuara	Të kolateralizuara	Të pa kolateralizuara
Mesatarja	12,011	2,256	15,513	2,336	3,837	1,815
Mediana	2,256	600	10,000	500	3,000	1,000
Maksimumi	562,500	90,750	562,500	90,750	50,000	25,000

Burimi: BQK.

Numri i njësive të kolateralit për kontratë kreditore, në mesatare, ishte 1.3 (Tabela 10). Mbi 80 përqind e kontratave të kolateralizuara kishin 1 njësi kolaterali, ndërsa maksimumi i njësive për kontratë arrin në 20. Në mesin e kontratave kreditore të mbështetura me kolateral, probabilitetin më të lartë të mbështetjes me më shumë se 1 njësi kolaterali e kishin kreditë për agrikulturë dhe ato për automjete.

Raporti i mbulueshmërisë (vlera e kolateralit ndaj vlerës së aprovuar të kredisë) së të gjitha kontratave kreditore me koleteral ishte në mesatare 1.3.<sup>17</sup> Mediana e raportit të mbulueshmërisë së kredisë me kolateral ishte 1.0, që sugjeron se për gjysmën e kontratave kreditore vlera e kolateralit është e njëjtë me vlerën e aprovuar të kredisë. Numri i njësive të kolateralit si dhe raporti i mbulueshmërisë ishte më i lartë në sektorin mikrofinanciar, produktet kreditore të të cilit kanë vlerë më të ulët. Raporti i mbulueshmërisë së kredive me kolateral kishte gjithashtu dallime të rëndësishme varësisht prej qëllimit të kontratave kreditore, ku kreditë për automjete u shquan me raportin më të lartë të kolateralit në raport me vlerën e kredisë prej 3.5, ndërsa kreditë për ndërtim dhe renovim me raportin më të ulët prej 0.6.

**Tabela 10. Raporti i mbulesës së kontratave kreditore me kolateral dhe numri i njësive të kolateralit, sipas sektorëve**

Përshkrimi	Numri i njësive të kolateralit për kontratë kreditore	Raporti i mbulueshmërisë së kontratës kreditore me kolateral	Numri i njësive të kolateralit për kontratë kreditore	Raporti i mbulueshmërisë së kontratës kreditore me kolateral	Numri i njësive të kolateralit për kontratë kreditore	Raporti i mbulueshmërisë së kontratës kreditore me kolateral
Mesatarja	1.32	1.33	1.19	1.15	1.62	1.7
Mediana	1.0	1.0	1.0	0.8	1.0	1.3
Maximumi	20.0	78.7	20.0	0.0	12.0	0.0
Minimumi	1	0.000013	1	78.7	1	33.3

Burimi: BQK.


#### 4.2.6 Huamarrësit dhe përdorimi i kreditit

Pjesa më e madhe e huamarrësve, 73.3 përqind, ishin huamarrës të shumëfishtë – huamarrës me disa kontrata kreditore aktive. Pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të gjithsej huamarrësve e kishin huamarrësit me tre kontrata kreditore (Grafiku 18).

Në mesatare, numri i kontratave aktive kreditore për huamarrës ishte 2.6, ndërsa numri maksimal i kontratave aktive që kishte një huamarrës shkonte në 9 (nëntë).


<sup>17</sup> E korrigjuar për vlerat ekstreme.

Grafiku 18. Shpërndarja e huamarrësve sipas numrit të kontratave kreditore



Burimi: BQK.


Grafiku 19. Shpërndarja e huamarrësve sipas numrit të institucioneve me të cilët është krijuar kontrata kreditore



Burimi: BQK.


Afër një e treta e huamarrësve ishin klient në disa institucione (dy e më shumë institucione) (Grafiku 19 & Grafiku 20). Siç është e pritshme, huamarrësit me numër më të madh të kontratave kreditore ishin më të prirur për të qenë klient të institucioneve të ndryshme dhe numri mesatar i institucioneve prej të cilave huamarrësi ka marrë kredi rritet me numrin e kredive. Në mesatare, një huamarrës kishte kontratë kreditore me 1.44 institucione kredidhënëse, ndërsa numri maksimal i institucioneve prej të cilave një huamarrës kishte marrë kredi arrinte në 6. Nga gjithsej huamarrësit që ishin klient të më shumë se një institucioni, 43.8 përqind kishin 3 (tre) apo më shumë kontrata aktive kreditore, për dallim nga vetëm 5.1 përqind për klientët e një institucioni.

Figura 20. Shpërndarja e huamarrësve sipas numrit të kontratave aktive kreditore dhe numrit të institucioneve



Burimi: BQK.

Grafiku 21. Shpërndarja e huamarrësve sipas llojit të institucionit




Burimi: BQK.

Më shumë se gjysma e huamarrësve, 51.5 përqind, kishin kontrata kreditore vetëm në banka, ndërsa 19.1 përqind vetëm në institucione mikrofinanciare. Pjesa e mbetur janë klientë të përbashkët të sektorit bankar dhe mikrofinanciar (Grafiku 21). Klientët e sektorit bankar kishin tendencë më të lartë të huamarrjes së shumëfishtë (Grafiku 22).


Pjesëmarrje e lartë e huamarrësve, 80.9 përqind, janë huamarrës me histori kreditore, përkatësisht janë “huamarrës të vjetër” që kanë kontrata kreditore të mbyllura. Më shumë se gjysma e huamarrësve me histori kreditore kishin 1 deri në 3 kontrata kreditore të mbyllura, ndërsa numri maksimal i kontratave të mbyllura arrinte në 26. Mesatarja e viteve të përvojës/përfshirjes në kredimarrje për huamarrësit me histori kreditore është 6.3 vite (maksimumi 20 vite e 9 muaj), krahasuar me 3.5 për huamarrësit që kanë vetëm kontrata aktive (maksimumi 12 vite e 2 muaj). Huamarrësit me histori kreditore kishin tendencë më të lartë për huamarrje të shumëfishtë: 78.4 përqind e tyre posedojnë më shumë se një kontratë aktive në raport me 56.3 përqind të huamarrësve pa histori kreditore. Nga huamarrësit me histori kreditore, 20.6 kishin më shumë se tri kontrata aktive në raport me vetëm 5.2 përqind të huamarrësve pa kredi kreditore.

Huamarrja e shumëfishtë ishte më e shprehur në vende urbane (Grafiku 23). Rajonet me numrin më të madh të huamarrësve me më shumë se një kontratë kreditore aktive rezultuan të jenë Prishtina dhe Prizreni, pasuar nga Peja (Grafiku 24).


Grafiku 22. Shpërndarja e huamarrësve sipas numrit të kontratave aktive kreditore dhe llojit të institucionit



Grafiku 23. Shpërndarja e huamarrësve sipas numrit të kontratave kreditore dhe llojit të banimit




Grafiku 24. Shpërndarja e huamarrësve sipas numrit të kontratave kreditore dhe rajonit




Shpërndarja e huamarrësve sipas llojit të kredisë tregon se 92.3 përqind e klientëve kishin hua aktive në portfolion e tyre kreditor. Kreditkartelat ishin produkti kreditor tjetër më i shpeshtë, ku 63.7 përqind e klientëve e posedonin këtë produkt. Ndërsa, nga e gjithë mostra e huamarrjeve, 48.2 përqind e huamarrësve rezultojnë të kenë mbitërheqje (Grafiku 25).

Grafiku 25. Shpërndarja e huamarrësve sipas llojit të kredisë dhe grupit të institucioneve kredidhënëse (si % e gjithsej huamarrësve)



Burimi: BQK.


Grafiku 26. Pjesëmarrja e vlerës së llojeve të kredive në gjithsej portfolion kreditor të huamarrësve



Burimi: BQK.

Pjesëmarrja e borxhit të mbetur të huave në gjithsej vlerën e mbetur të portfolios së huamarrësit<sup>18</sup> ishte 88.9 përqind. Ndërsa, pjesëmarrja e vlerës së mbetur të mbitërheqjeve në gjithsej portfolion e huamarrësve ishte e ulët, 0.7 përqind. Kjo kryesisht për shkak të vlerës më të ulët të mbitërheqjeve, si dhe për shkak të bilancit zero të shumë mbitërheqjeve aktive. Ngjashëm ishte edhe me kreditkartelat, vlera e të cilave përbënte vetëm 2.6 përqind të vlerës së përgjithshme të portfolios së huamarrësve. Pjesëmarrja e kredive hipotekare në gjithsej portfolion kreditor ishte 7.1 përqind (Grafiku 26). Vlera mesatare e borxhit mujor për huamarrës, përkatësisht mesatarja e shumës së kësteve mujore së të gjitha huave aktive, ishte 257.0 euro. Mediana ishte 201.5 euro, që nënkupton që gjysma e huamarrësve kishin kështu kreditor për huatë në vlerë deri në 200 euro (Grafiku 27). Ndërsa, shumata mesatare e kështit për të gjitha produktet kreditorë, bazuar në supozimin se gjithsej shumata e mbetur borxh për produktet tjera si kreditkartelat dhe mbitërheqjet është kështu mujor, është dyfish më e lartë, 572.8 euro, dhe mediana është 323.4 euro.

Grafiku 27. Shpërndarja e kështit mujor sipas vlerës



Burimi: BQK.

#### 4.2.7 Bashkë-huamarrja


Afër një çerek e huamarrësve, përkatësisht 23.5 përqind, ishin të përfshirë në bashkë-huamarrje, shumica e të cilëve kishin rol bashkë-huamarrës në vetëm një kontratë kreditorë (Grafiku 28). Maksimumi i kontratave bashkë-huamarrëse arrinte në 29.

Huamarrësit e shumëfishtë - me më shumë se një kontratë aktive kreditorë - kishin më shumë tendencë të përfshirjes në bashkë-huamarrje, 25.6 përqind e të cilëve ishin bashkë-huamarrës në krahasim me 17.4 përqind të atyre me një kontratë aktive kreditorë. Gjithashtu, probabiliteti për

<sup>18</sup> Portfolio e huamarrësit nënkupton shumën e vlerës së të gjitha produkteve aktive kreditorë të huamarrësit.


përfshirje në bashkë-huamarrje rritej me rritjen e numrit të kontratave aktive kreditore (Grafiku 29).

Grafiku 28. Shpërndarja e bashkëhuamarrësve sipas numrit të bashkëhuamarrjeve



Burimi: BQK.

Grafiku 29. Shpërndarja e bashkëhuamarrësve sipas numrit të kontratave aktive kreditore




Burimi: BQK.

Huamarrësit me kredi aktive nga më shumë se një institucion kredidhënës kishin relativisht më shumë tendencë të ishin të përfshirë në bashkë-huamarrje, në krahasim me klientët e një institucioni.<sup>19</sup>

Dallimet në probabilitetin e bashkë-huamarrjes ishin më të theksuara ndërmjet huamarrësve me kredi vetëm në sektorin bankar dhe atyre të sektorit mikrofinanciar. Këta të fundit kishin probabilitet më të ulët të bashkë-huamarrjes (17.06 përqind krahasuar me 24.9 përqind për klientët e bankave, si dhe 25.0 përqind për klientët e përbashkët të bankave dhe mikrofinancave).

Tendencat për përfshirje në bashkë-huamarrje dallonin sipas disa karakteristikave socio-demografike. Gratë ishin më shpesh të përfshira në bashkë-huamarrje në krahasim me burrat, si dhe huamarrësit në vende urbane kishin tendencë më të shpeshta të përfshirjes në bashkë-huamarrje në krahasim me huamarrësit nga vende rurale (Grafiku 30). Sipas rajonit, huamarrësit nga Prishtina ishin

Grafiku 30. Shpërndarja në bashkëhuamarrje e klientëve sipas gjinisë dhe vendbanimit



Burimi: BQK.

më së shpeshti të përfshirë në bashkë-huamarrje (27.2 përqind e tyre), ndërsa huamarrësit nga rajoni i Gjilanit më së rralli (15 përqind).

<sup>19</sup> Dallimi rezulton i rëndësishëm statistiki vetëm në 10 përqind nivel të significancës.

Të hyrat mesatare të bashkë-huamarrësve ishin për 160 euro më të larta se të huamarrësve që nuk ishin të përfshirë në bashkë-huamarrje. Edhe të hyrat e ekonomive familjare të bashkë-huamarrësve kanë rezultuar më të larta se të klientëve jo-bashkë-huamarrës. Menaxherët si dhe huamarrësit me profesione me nivel më të lartë të shkathtësive siç janë profesionistët, që njëherësh kanë edhe pagë më të lartë, kishin probabilitet më të lartë të bashkë-huamarrjes.

Nga gjithsej huamarrësit, 38.4 përqind ishin të përfshirë në rolin e garantuesit apo të bashkë-huamarrësit, ndërsa 5.7 përqind në të dy rolet njëkohësisht. Bashkë-huamarrësit kishin tendencë që më shpesh të jenë garantues në kontrata të tjera kreditore (Grafiku 31).


Sa i përket llojit të kontratës kreditore, bashkë-huamarrësit ishin më shpesh përdorues të kreditkartelave dhe mbitorheqjeve sesa jobashkë-huamarrësit. Huamarrësit me histori kreditore kishin përfshirje më të lartë në bashkë-huamarrje. Ndërsa, rreth 3.0 përqind e gjithsej bashkë-huamarrësve ishin të përfshirë në bashkë-huamarrje me vonesa për më shumë se 30 ditë.

#### 4.2.8 Garancionet për klientët tjerë

Rolin e garantuesit për kontrata të tjera kreditore e ushtronin 20.6 përqind të huamarrësve, pjesa më e madhe e të cilëve ishin garantues të një kontrate kreditore (Grafiku 32). Numri maksimal i kontratave të garantuara ishte 15. Huamarrësit e shumëfishtë - me më shumë se një kontratë aktive kreditore - kishin tendencë më të lartë për pjesëmarrje në garancione, tendencë e cila rritej me rritjen e numrit të kontratave kreditore (Grafiku 33). Gjithashtu, huamarrësit që kishin kontrata kreditore në


institucione të ndryshme kredidhënëse ishin huamarrës më shpesh të përfshirë në garancione. Klientët me kredi aktive në sektorin bankar ishin më shpesh garantues krahasuar me klientët me kredi vetëm në sektorin mikrofinanciar (Grafiku 34).

Grafiku 31. Shpërndarja e huamarrësve sipas rolit bashkëhuamarrës dhe garantues




Burimi: BQK.

Grafiku 32. Shpërndarja e huamarrësve sipas numrit të kontratave të garantuara (si % e gjithsej garantuesve)




Burimi: BQK.

Grafiku 33. Pjesëmarrja në garancione e huamarrësve sipas numrit të kontratave të veta kreditore (si % e gjithsej huamarrësve)



Burimi: BQK.

Grafiku 34. Pjesëmarrja në garancione e huamarrësve sipas numrit dhe llojit të institucionit (si % e gjithsej huamarrësve)



Burimi: BQK.


Në baza gjinore, burrat rezultojnë të jenë më shpesh garantues në krahasim me gratë (22.7 përqind krahasuar me 15.8 përqind garantuese gra). Ndërsa, përfshirja në garancione nuk kishte dallime të rëndësishme sipas vendbanimit dhe rajoneve. Sipas profesioneve, probabiliteti i përfshirjes në garancione ishte i më i lartë tek punëtorët e zyrave dhe asistentët, si dhe punonjësit e shitjes. Tendencat për garancione ishin më të larta te huamarrësit me përvojë pune mbi 6 vite, dhe tek ata në moshë më të shtyer (përkatësisht grup-moshat 41-50 si dhe 51-60 vjet). Paga mesatare e huamarrësve që shërbenin si garantues për të tjerët ishte më e lartë për 188.3 euro, përderisa edhe paga mesatare e ekonomive familjare të huamarrësve garantues rezultoi të jetë më e lartë. Sikurse tek bashkë-huamarrja, klientët me histori kreditore kishin përfshirje më të lartë në garancione. Sa i përket llojit të kontratave aktive kreditore, garantuesit rezultuan të jenë më shpesh përdorues të kreditkartelave, mbitërheqjeve dhe produkteve tjera kreditore. Rreth 5.1 përqind e garantuesve ishin të përfshirë në garantim të kontratave kreditore me vonesa në pagesë për më shumë se 30 ditë.

### 4.3. Performanca në shlyerjen e borxheve

#### 4.3.1 Performanca e pagesës të kontratave aktive kreditore

Nga gjithsej kontratat aktive, 94.0 përqind kishin performancë të mirë të pagesës, ndërsa 5.5 përqind prej tyre kishin vonesë më shumë se 30 ditë në pagesë. Pjesëmarrja e kontratave në vonesë ishte më e lartë në sektorin mikrofinanciar, 13.1 përqind, krahasuar me 3.6 përqind në sektorin bankar (Grafik 35). Por, dallimet në shkallën e vonesave ndërmjet institucioneve ishin të theksueshme.

Grafik 35. Shpërndarja e kontratave kreditore të vonuara në pagesë (>30 ditë) sipas sektorëve




Burimi: BQK.

Në sektorin bankar, shkalla maksimale e kredive me vonesë ishte 8.8 përqind nga njëra bankë. Ndërsa, në sektorin mikrofinanciar, shkalla e vonesave të




kredive bie në 4.7 përqind kur largohen kreditë e lëshuara nga dy institucionet të cilave iu është marrë licenca e operimit<sup>20</sup>, njëra nga të cilat ka shkallë të lartë të vonesës prej 83 përqind. Shkalla maksimale e vonesave (kreditë e vonuara mbi 30 ditë në raport me kreditë aktive të institucionit përkatës) në mesin e institucioneve mikrofinanciare me licencë aktive arrin në 45.5 përqind.

Grafik 36. Shpërndarja e kontratave kreditore të vonuara në pagesë (>30 ditë) sipas llojit të kontratës dhe sektorit



Burimi: BQK.

Grafik 37. Pjesëmarrja e kontratave kreditore të vonuara në pagesë (>30 ditë) sipas fazës së maturimit




Burimi: BQK.

Produktet kreditore me përqindje më të lartë të vonesave rezultojnë huatë, ndikuar nga sektori mikrofinanciar, përkatësisht huatë e njëjës nga institucionet mikrofinanciare të cilës i është revokuar licenca e operimit. Në sektorin bankar, kreditkartelat janë produkti me më së shumti raste të vonesave, pasuar nga huatë (Grafik 36).

Performanca e pagesës tregon ndërlidhje me fazën e maturimit në të cilën gjenden kontratat kreditore. Kontratat kreditore që ishin në çerekun e fundit të periudhës së maturimit kishin pjesëmarrje më të lartë të vonesave (Grafik 37). Në përgjithësi, mund të thuhet se problemet me vonesa në pagesë ishin shumë më të shprehura në gjysmën e dytë të maturimit të kontratës (kur kontrata kreditore të ketë përfunduar gjysmën e kohës së maturimit), që përkon me faktin që kapaciteti i pagesës është më i vështirë të parashikohet për periudha më të largëta. Sidoqoftë, në kundërshtim me pritjet në raport me relacionin e drejtë të rrezikut dhe kohëzgjatjes së kontratave kreditore, kohëzgjatja mesatare e kontratave me vonesa në pagesë më shumë se 30 ditë ishte më e shkurtër (42 muaj) se e kontratave me performancë të mirë të pagesës (68 muaj).

Në sektorin bankar, dallimi në mes të kohëzgjatjes së kontratave me dhe pa vonesa reduktohet pothuajse plotësisht kur analizohen vetëm huatë, ndërsa me përfshirjen e kreditkartelave dhe mbitërheqjeve dallimi rritet (kohëzgjatja e kontratave pa vonesa rritet në krahasim me kontratat me vonesa).

Grafik 38. Huatë në vonesë (<30 ditë) dhe kolateralizimi, sipas sektorëve



Burimi: BQK.


<sup>20</sup> Monego dhe Iute Credit

Në sektorin mikrofinanciar, huatë me vonesa kanë maturitet më të shkurtër (në mesatare 16.8 muaj) në raport me huatë pa vonesa 26.3 muaj. Ky rezultat mund të sugjerojë që huamarrësve me rrezikshmëri më të lartë i'u lëshohen kredi me maturitet më të shkurtër, pikërisht për shkak të rrezikut më të madh për kthim.

Kontratave kreditore në vonesë rezultojnë me shumë mesatare më të ulët - në përgjithësi si dhe analizuar sipas produkteve të ndryshme kreditore - gjë që sugjeron se institucionet financiare aprovojnë kontrata kreditore me maturitet dhe vlerë më të shkurtër për huamarrësit me probabilitet më të lartë të problemeve në ripagim.


Pjesëmarrja e lartë prej 75 përqind e kontratave kreditore me vonesa nuk kanë rezultuar të kolateralizuara, si në sektorin bankar ashtu edhe në atë mikrofinanciar (70.1 përqind në sektorin bankar dhe 80.9 përqind në sektorin mikrofinanciar). Në sektorin mikrofinanciar, i cili ka kryesisht vetëm hua, me largimin e dy institucioneve të cilave i'u është larguar licenca e operimit, pjesëmarrja e huave me vonesa të cilat nuk janë të kolateralizuara bie dukshëm në 35.9 përqind. Ndërsa në sektorin bankar, pjesëmarrja e kontratave kreditore me vonesa të cilat nuk janë kolateralizuar bie dukshëm në 44.0 përqind me largimin e kreditkartelave, si produkt kreditor me pjesëmarrje të lartë por që është produkt i pakolateralizuar. Nëse konsiderohen vetëm huatë e sektorit bankar (përfshihen edhe mbitërheqjet dhe llojet e tjera të produkteve kreditore), pjesëmarrja bie tutje në 30.8 përqind (Grafik 38).

Grafik 39. Raporti i vlerës së kolateralit ndaj vlerës së huasë, sipas sektorëve




Burimi: BQK.

Grafik 40a. Kontratave kreditore të vonuara në pagesë (>30 ditë) në sektorin bankar, sipas vitit të disbursimit



Burimi: BQK.

Grafik 40b. Kontratave kreditore të vonuara në pagesë (>30 ditë) në sektorin mikrofinanciar, sipas vitit të disbursimit




Burimi: BQK.

Mbulesa me kolateral e të gjitha produkteve kreditore në vonesë ishte 0.33 përqind, krahasuar me mesataren prej 0.42 për gjithsej kreditë aktive. Ndërsa, mbulesa me kolateral për të gjitha produktet kreditore në vonesë por që ishin të kolateralizuara ishte 1.33 përqind, ngjashëm me mesataren për gjithsej kreditë aktive. Mbulesa me kolateral rritet në 1.48 kur konsiderohen vetëm huatë e kolateralizuara por që janë në vonesë (Grafik 39). Në sektorin bankar mbulesa me kolateral


e huave në vonesë është më e ulët se në sektorin mikrofinanciar, 1.23 dhe 1.84 përqind respektivisht.

Grafik 41a. Ndryshimi vjetor i kreditimit, sektori bankar



Burimi: BQK.

Grafik 41b. Ndryshimi vjetor i kreditimit, sektori mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Kontratat kreditore të lëshuara në vitin 2017 dhe 2019 kishin më së shumti raste të vonesave (8.8 përqind). Ndaras sipas sektorëve, kontratat e lëshuara nga bankat në periudhën para vitit 2019 kishin shkallë më të lartë të vonesës, ndërsa nga viti 2019 e tutje shkalla e vonesave shënon rënie (Grafiku 40a). Edhe në sektorin mikrofinanciar kemi rënie të shkallës së vonesave të kontratave të lëshuara në vitet e fundit (Grafik 40b). Ky rezultat, përveç që ndërlidhet me konstatimin e më hershëm që kontratat kreditore kanë probabilitet më të lartë të vonesës në gjysmën e dytë të maturimit, gjithashtu mund të sugjeroj për rritje të përgjithshme të aftësive të vlerësimit të rrezikut në vitet e fundit. Për më tepër, vonesat më të larta të kredive të lëshuara në vitet 2014-2017 mund të ndërlidhen me rritjen më të lartë të kreditimit (Grafik 41a dhe 41b) dhe lehtësim të standardeve dhe kushteve kreditore (të sugjeruar edhe nga rezultatet e anketës së kreditimit bankar), që mund të nënkuptojë se qasja në kredi mund t'i jetë mundësuar edhe kredimarrësve me cilësi më të ulët.

Dallimet sipas institucioneve janë të rëndësishme edhe në shpërndarjen e kredive me vonesa sipas vitit të lëshimit, me ç'rast shkalla më e lartë e vonesave të kredive të sektorit bankar, të lëshuara në vitin 2014, ndikohet pothuajse plotësisht nga 2 institucione. Në sektorin mikrofinanciar, me përjashtim të dy institucioneve të cilave i'u është revokuar licenca, shkalla e vonesave të kredive sipas vitit të disbursimit bie dukshëm në vitin 2018 dhe 2019 (11.5 përqind dhe 3.54 përqind).

Sipas qëllimit për të cilin shfrytëzohet produkti kreditor, më së shpeshti vonesa kishin kontratat kreditore për asete aktuale si dhe ato për konsum (Grafik

Grafik 42. Kontratat kreditore të vonuara në pagesë (>30 ditë) sipas qëllimit dhe sektorëve (si % e gjithsej kontratave kreditore aktive të qëllimit përkatës)



Burimi: BQK.

42). Vonesat në kreditë për konsum ndikohen kryesisht nga sektori mikrofinanciar, përkatësisht nga vonesat e dy institucioneve me licencë të revokuar, largimi i të cilave e zbrit shkallën e vonesave për kredi konsumuese në 5.4 përqind për gjithsej sektorin. Kontratat për ndërtim dhe renovim si dhe qëllime tjera kishin pjesëmarrjen më së ulët të vonesave në pagesë.


### 4.3.2 Performanca e pagesës së huamarrësve

Nga gjithsej huamarrësit, 9.5 përqind kishin vonesë të pagesës së kësteve kreditore për më shumë se 30 ditë (Grafik 43). Në kuadër të vonesave, pjesëmarrjen më të lartë e kishin vonesat për më shumë se 180 ditë.

Tendencat më të larta të vonesave ishin në mesin e huamarrësve të shumëfishtë, por nga institucione të ndryshme (Grafik 44). Shkalla e vonesave të huamarrësve rritet theksueshëm në rastet kur huamarrësit kanë kredi aktive në disa institucione, përkatësisht 22.4 përqind e


këtyre huamarrësve janë në vonesë, krahasuar me vetëm 2.0 përqind të huamarrësve të shumëfishtë por në të njëjtin institucion. Ky rezultat konfirmon pritjet se vlerësimi i performancës aktuale të pagesës dhe kapacitetit të pagesës në të ardhmen, për huamarrësit që janë klientë në disa institucione njëkohësisht, është më i vështirë, në raport me huamarrësit që kanë disa kredi por nga i njëjti institucion. Marrëdhënia më e gjatë e klientit me një institucion zvogëlon asimetrinë e informacionit për sjelljen e klientit dhe performancën e të hyrave të tij, duke e vendosur atë në pozitë më të favorshme për vlerësim më adekuat të rrezikut.

Grafik 43. Shpërndarja e huamarrësve sipas kohës së vonesës së kontratave (si % e gjithsej huamarrësve)




Burimi: BQK.

Grafik 44. Performanca e pagesës sipas numrit të kontratave dhe institucioneve



Burimi: BQK.

Grafik 45. Performanca e pagesës së huamarrësve sipas llojit të institucionit ku është klient




Burimi: BQK.


Vonesat ishin më të shpeshta në grupin e huamarrësve që kishin kredi në sektorin bankar dhe mikrofinanciar njëkohësisht, 16 përqind e të cilëve ishin në vonesë krahasuar me vetëm 4.6 përqind të klientëve vetëm në banka dhe 12 përqind të atyre vetëm në mikrofinanca (Grafik 45).

Rreth 72 përqind e vlerës së kredisë në vonesë i takonte huamarrësve me kredi në banka dhe mikrofinanca njëkohësisht (Grafiku 46). Përkundër numrit më të madh të vonesave të klientëve vetëm në mikrofinanca krahasuar me ata vetëm në banka, pjesëmarrja e shumës së kredisë në vonesë ishte më e lartë për klientët e bankave për shkak të shumës më të lartë të kredisë të vonuara.

Grafik 46. Shuma e mbetur borxh e klientëve sipas vonesave dhe llojit të institucionit (si % e shumës së mbetur në kategoritë përkatëse të vonesave)




Grafik 47. Shpërndarja e huamarrësve sipas numrit të kontratave kreditore dhe vonesave



Probabiliteti i vonesave të huamarrësve përgjithësisht rritej me rritjen e numrit të kontratave kreditore, me ç'rast huamarrësit me më shumë se tri kontrata kreditore kishin më së shumti vonesa (Grafik 47). Burrat kishin më shumë vonesa në pagesën e kredisë se gratë (Grafiku A1, Shtojca 3). Performanca e pagesës nuk kishte dallime të rëndësishme sipas historisë kreditore apo karakteristikave socio-demografike tjera si statusi, lloji i vendbanimit, rajoni apo numri i të punësuarve në ekonomi familjare. Dallimet theksoheshin ndërmjet huamarrësve të profesioneve të ndryshme: shkalla e vonesave ishte më e lartë në mesin e huamarrësve me profesione me kualifikime më të ulëta, që gjithashtu karakterizohen me jo-stabilitet të vendit të punës, të ardhura më të ulëta dhe/apo jo të rregullta.


Grafik 48. Performanca e pagesës së klientëve sipas performancës së kontratave ku janë garantues (si % e huamarrësve)



Performanca e pagesës së kontratave bashkë-huamarrëse dhe garancioneve rezultoi të jetë e ndërlidhur me performancën e pagesës së huamarrësve në kontratat e veta kreditore. Pjesëmarrja e vonesave në mesin e huamarrësve që ishin garantues në kontrata kreditore në vonesë ishte më e lartë, përkatësisht 33.3 përqind në raport me 9.9 përqind të huamarrësve që garantonin kontrata që nuk kishin vonesa (Grafik 48).

Vonesat ishin edhe më të larta tek huamarrësit që ishin bashkë-huamarrës në kontrata në vonesë, me ç'rast 57.1 përqind e tyre ishin në vonesë në kontratat e tyre kreditore në krahasim me vetëm 7.9 përqind të huamarrësve të përfshirë në bashkë-huamarrje pa vonesa (Grafik 49). Ky rezultat është i pritshëm për faktin që në rastin e bashkë-huamarrjes, përgjegjësitë për pagesën e kontratës janë të përbashkëta dhe problemet në pagesën e kështit në bashkë-huamarrje mund të sinjalizojnë që klienti ka vështirësi financiare që mund të reflektohet edhe në pagesën e kredisë së tij individuale, dhe anasjelltas.

**Grafik 49. Performanca e pagesës së klientëve sipas performancës së kontratave ku janë bashkëhuamarrës (si % e huamarrësve)**




Burimi: BQK.

### 4.3.3 Trendet e pagesës së kredive

Pjesëmarrja e të gjitha pagesave me vonesë më shumë se 30 ditë në gjithsej numrin e pagesave të kësteve kreditore të realizuara gjatë vitit përkatës tregon trend të qëndrueshëm prej mesatarisht 2.7 përqind në dhjetë vitet e fundit, megjithëse me tendencë rritëse nga viti 2018 (Grafik 50). Vitet pas pandemisë COVID-19 shënojnë shkallën më të lartë të pagesave me vonesë, prej 3.4 përqind në 2020 dhe 4.0 përqind në 2021.


Pjesëmarrja e pagesave me vonesë sipas kohës së vonesës (klasifikimet kreditore sipas ditëve në vonesë) tregon që vonesat për periudha më të shkurtra kishin trend më të qëndrueshmen me oscilime të vogla ndër vite. Ndërsa vonesat më afatgjata, përkatësisht mbi 90 ditë, kishin trend stabil deri në vitin 2018, kur edhe filluan rritjen e pjesëmarrjes.

**Grafik 50. Pjesëmarrja e ripagimeve me vonesë në gjithsej ripagimet sipas viteve**



Burimi: BQK.


**Grafik 51. Mesatarja e pjesëmarrjes së pagesave me vonesa sipas kohës së vonesës ( % e gjithsej pagesave për vitin përkatës)**



Burimi: BQK.

Në pothuajse të gjitha vitet, vonesat më të shpeshta ishin në kohëzgjatje prej më shumë se 180 ditë. Sidoqoftë, pjesë e vogël e këtyre kontratave kreditore rezultojnë në humbje, siç edhe vërehet në grafikun 51 ku pjesëmarrja e humbjeve ishte e ulët, në 0.1 përqind në mesatare. Përkundër rritjes së pjesëmarrjeve të vonesave në vitet pas krizës pandemike COVID-19, pjesëmarrja e shlyerjeve ka shënuar rënie, për shkak të masave lehtësuese dhe ristrukturimeve kreditore.


**Grafik 52. Mesatarja e pjesëmarrjes së pagesave me vonesë (>30 ditë) sipas vitit të lëshimit të kredive**



Burimi: BQK.

Në grafik 52 është paraqitur pjesëmarrja e pagesave me vonesë sipas vitit të lëshimit të kredisë. Kreditë e lëshuara në vitin 2012 dhe 2015 rezultojnë me pjesëmarrjen më të lartë të vonesave, në raport me mesataren prej 2.5 përqind për dhjetë vitet e fundit.

**Grafik 53. Shpërndarja e huamarrësve sipas indeksit kryesor të ngarkesës**




Burimi: BQK.

rezultojnë 27.4 përqind të huamarrësve. Më konkretisht, 21.8 përqind e huamarrësve cilësohen si në rrezik për mbingarkesë, ngase pjesëmarrja e borxhit ndaj të hyrave shtrihet në intervalin 50-75 përqind. Në fazën kritike janë 3.8 përqind të huamarrësve, borxhi mujor i të cilëve tejkalon 75 përqind e të hyrave. Ndërsa, 1.8 përqind të huamarrësve rezultojnë jo-solvent meqenëse shumica e të gjitha kësteve të huave të tyre aktive tejkalon të hyrat mujore (Grafiku 53).

<sup>21</sup> Indeksi i ngarkesës për huamarrësin individual është llogaritur për 90.7 përqind të klientëve të mostrës së përzgjedhur, përkatësisht për 1,805 observime.


<sup>22</sup> Huatë me këste të parregullta të pagesës janë përjashtuar nga kalkulimi ngase negociohen më mënyrë të tillë që pagesa e kështit të bëhet në disa periudha, që zakonisht përkohë me inkasim të hyrave të parregullta (kryesisht përfshijnë huatë Agro të dhëna për individ, të cilat karakterizohen me sezonalitet në inkasimin e të hyrave ndaj dhe pagesa e kështit përshtatet me këto periudha).

Grafik 53a. Shpërndarja e huamarrësve sipas indeksit të ngarkesës për hua dhe mbitërheqe



Burimi: BQK.


Grafik 53b. Shpërndarja e huamarrësve sipas indeksit të ngarkesës për të gjitha produktet kreditore (hua, mbitërheqe dhe kreditkartela)



Burimi: BQK.

Në rast të përfshirjes së të gjitha produkteve kreditore për përlogaritjen e ngarkesës me borxh, pjesëmarrja e huamarrësve të mbingarkuar rezulton më e lartë dhe konsiderohet e mbivlerësuar. Kjo për faktin se në këstin mujor është përfshirë gjithsej borxhi i mbetur në kreditkartelë/mbitërheqe - në mungesë të informacionit por edhe në vështirësi të identifikimit të numrit të kësteve për pagesën e borxhit të këtyre produkteve – përderisa pagesa e borxhit të këtyre produkteve zakonisht bëhet në këste (kreditkartelat) apo në maturim të kontratës (mbitërheqjet). Rezultatet e ngarkesës për të gjitha produktet kreditore, bazuar në supozimet e lartcekura konzervative, janë paraqitur në grafikët 53a dhe 53b. Ndërsa, analiza në vijim e ndërlidhjeve të nivelit të ngarkesës me karakteristikat demografike dhe modelet e huamarrjes bazohet në indeksin kryesor të ngarkesës bazuar vetëm në borxhin e huave. Niveli i ngarkesës me borxh nuk kishte dallime statistikisht të rëndësishme<sup>23</sup> sipas shumicës së karakteristikave socio-demografike, përkatësisht gjinisë, statusit martesor, moshës, viteve të përvojës në punë, llojit të vendbanimit dhe rajonit. Dallimet theksohen analizuar sipas profesioneve të huamarrësve, dhe nivelit të hyrave mujore.

Grafik 54. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas profesionit



Burimi: BQK.

Pensionistët, punëtorët e zyrave dhe asistentët ishin grupet me pjesëmarrjen më të lartë të huamarrësve të mbingarkuar me borxh. Pensionistët kishin gjithashtu pjesëmarrjen më të lartë në grupin e huamarrësve jo-solvent (borxhin më të lartë se të hyrat), pasuar nga punonjësit e aftësuar në bujqësi, pylltari dhe peshkatari (Grafiku 54).

<sup>23</sup> Rëndësia statistike është konsideruar vetëm për 1% dhe 5% të nivelit të konfidencës



Niveli i ngarkesës ndërlidhet me nivelin e të ardhurave që gjenerojnë profesionet e ndryshme, me ç'rast profesionet me të ardhura më të ulëta, si dhe ata me të ardhura me sezonalitet të lartë, siç janë punëtorët e sektorit të agrikulturës, rezultojnë më të mbingarkuar.

Grupi i huamarrësve me të ardhura më të ulëta (deri në 170 euro) ishin më të mbingarkuar. Niveli më i lartë i të ardhurave të huamarrësve asocohet me nivel më të ulët të mbingarkesës për grupet me të ardhura deri në 1,000 euro (Grafiku 55).

Mbingarkesa më e lartë në grupet me të hyra mbi 1,000 euro, krahasuar grupit me të hyra prej 750-999 euro që njëherësh ka nivelin më të ulët të mbingarkesës, në masë të konsiderueshme shpjegohet nga fakti se në këto grupe përfshihen huamarrës individual me biznese të pajegjistruara, të cilët punojnë në sektorin e agrikulturës, dhe të cilët gjenerojnë të hyra jo-të rregullta por kanë këste mujore të larta. Shkaku tjetër për nivelin e lartë të jo-solventës që rezulton në grupet e huamarrësve me të hyra të larta është huamarrja e shumëfishtë (këste të larta mujore). Duhet theksuar se kapaciteti i pagesës së të gjitha grupeve të huamarrësve, mund të jetë përforcuar nga përfshirja e bashkë-huamarrësve, gjë e cila nuk reflektohet në këto rezultate për shkak të mungesës së informacionit.<sup>24</sup>


Vlera e këstit mujor ishte mesatarisht më e ulët te huamarrësit pa probleme me borxh, përderisa rritja e vlerës së këstit asocohet me rritje të ngarkesës së huamarrësit. Po ashtu, shumica e vlerës së aprovuar për huatë aktive si dhe shumica e borxhit të mbetur ishin mesatarisht më të ulëta për huamarrësit që nuk kishin probleme me mbingarkesë dhe niveli i tyre ishte më i lartë në mënyrë progresive me nivel më të lartë të ngarkesës (Tabela 11).

**Tabela 11. Niveli i ngarkesës dhe të hyrat mujore, kësti mujor, vlera e aprovuar dhe vlera e mbetur e huave (në euro)**

Nivelet e ngarkesës	Mesatarja e të hyrave mujore neto të huamarrësit	Mesatarja e vlerës së këstit mujor të huave	Mesatarja e vlerës së aprovuar të huave aktive	Mesatarja e vlerës së mbetur të huave aktive
Të pa ngarkuar	740.5	200.0	8,814.2	5,834.9
Në rrezik	649.6	356.1	22,085.6	15,063.2
Në fazë kritike	632.3	492.2	36,876.6	27,546.2
Josolvent	837.7	876.8	53,551.3	35,546.1

Burimi: BQK.

**Grafik 55. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas të hyrave mujore**




Burimi: BQK.


<sup>24</sup> Në vlerësimin e kapacitetit ripagues të kredisë/ngarkesës me borxh të individit, nuk posedojmë informacion se a ka bashkë-huamarrës të përfshirë në huatë e tij. Prandaj, mos përfshirja e bashkë-huamarrësve, përkatësisht të hyrave të bashkë-huamarrësve, mund të ndikojë në mbivlerësimin e ngarkesës me borxh të individëve.

Mbingarkesa ishte më e shprehur te huamarrësit e shumëfishtë, përkatësisht grupi me tri e më shumë kontrata kreditore aktive (Grafik 56). Shkalla e mbingarkesës ishte pothuajse dyfish më e lartë tek huamarrësit e shumëfishtë me kontrata nga institucione të ndryshme në krahasim me huamarrësit me disa kredi aktive por nga i njëjti institucion: 40.5 përqind, respektivisht 24.2 përqind. Mos-aftësia e shlyerjes së borxhit (jo-solvenca) ishte gjithashtu theksueshëm më e lartë në mesin e huamarrësve të shumëfishtë me kredi në disa institucione, 3.6 përqind, për dallim nga 0.8 përqind në mesin e atyre me disa kredi por nga i njëjti institucion (Grafik 57).

Grafik 56. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas numrit të kontratave kreditore




Grafik 57. Niveli i ngarkesës së huamarrësve të shumëfishtë sipas numrit të institucioneve kredidhënëse




Huamarrësit e shumëfishtë, me kredi paralele në dy sektorët kredidhënës (banka dhe mikrofinanca) ishin ndër më të mbingarkuarit. Analizuar ndaras sipas sektorëve, huamarrësit me kontrata kreditore vetëm në sektorin bankar kanë shkallë më të lartë të ngarkesës në krahasim me ata të sektorit mikrofinanciar, 25.7 përqind në raport me 15.6 përqind. Shkalla e huamarrësve jo-solvent gjithashtu është dukshëm më e lartë te huamarrësit me kredi vetëm në sektorin bankar: 1.7 përqind në raport me vetëm 0.3 përqind (Grafiku 58).

Grafik 58. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas llojit të institucionit




Vonesat në pagesën e kështit të kredisë treguan lidhshmëri të drejtë me nivel më të lartë të ngarkesës. Huamarrësit me vonesa ishin të mbingarkuar në 40.0 përqind të rasteve, krahasuar me 26.1 përqind të huamarrësve pa vonesa. Gjithashtu, rastet e jo-solventës ishin më të shpeshta te huamarrësit me vonesa, nga të cilët 2.3 përqind rezultuan jo-solvent krahasuar me 1.7 përqind të huamarrësve me performancë të rregullt të pagesës (Grafik 59).

Grafik 59. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas klasifikimit kreditor




Burimi: BQK.

Grafik 60. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas statusit të kolateralizimit të huave




Burimi: BQK.

Grafik 61. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas historisë kreditore të huamarrësit



Burimi: BQK.

Grafik 62. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas rolit bashkëhuamarrës/garantues




Burimi: BQK.

Niveli i ngarkesës me borxh ishte më i lartë për huamarrësit me hua të kolateralizuara, me ç'rast 32 përqind e tyre ishin të mbingarkuar, në krahasim me 13 përqind të huamarrësve që nuk kishin mbështetur huatë me kolateral (Grafik 60).

Ky rezultat ndërlihet me faktin se huatë e pakolateralizuara kanë vlerë shumë më të ulët se huatë e kolateralizuara në mesatare (5,419 euro, respektivisht 12,159 euro), andaj dhe kësti për pagesë është më i ulët (ngarkesë më e ulët). Gjithashtu, ky rezultati mund të sugjeroj se institucionet

Grafik 63. Niveli i ngarkesës së huamarrësve sipas statusit të ristrukturimit të huave



Burimi: BQK.

financiare kanë qasje më konservative në kreditimin e huamarrësve me kapacitetin më të ulët të

pagesës (shkallë më të lartë të borxhit ndaj të hyrave) për rastet kur nuk paraqitet kolaterali si mbështetje.

Huamarrësit me histori kreditore (kontrata kreditore të likuiduara) ishin më të pirur për të qenë të mbingarkuar me borxh (Grafik 61). Kjo mund të ndërlidhet me faktin se institucionet financiare janë më konzervative (tolerojnë normë më të lartë të borxhit ndaj të hyrave) në kreditimin e klientëve të ri, për shkak të probabilitetit më të lartë për asimetri të informacionit.

Huamarrësit të cilët ishin bashkë-huamarrës apo garantues në kontrata tjera kreditore ishin më të mbingarkuar me borxh (Grafik 62). Përkatësisht, huamarrësit e përfshirë në bashkë-huamarrje si dhe garancione njëkohësisht, kishin shkallë më të lartë të mbingarkesës.

Huamarrësit me kredi të ristrukturuara, në përputhje me pritshmëritë, rezultojnë më të mbingarkuar me borxh (Grafik 63).<sup>25</sup>


Ngarkesa me borxh e huamarrësve rezulton më e lartë në periudhën pas pandemisë COVID-19 (Grafik 64). Sidoqoftë,

këto rezultate nuk reflektojnë plotësisht ndikimin e pandemisë dhe përgjithësisht duhet të merren me rezervë, për shkak të mos-konsistencës së periudhës kohore që të dhënat reflektojnë.<sup>26</sup>

#### 4.4.2 Ngarkesa me borxh e ekonomive familjare

Indeksi kryesor i ngarkesës me borxh për ekonomitë familjare është llogaritur për 87.9 përqind të mostrës së huamarrësve, përkatësisht 1,751 observime. Nga kjo mostër e ekonomive familjare, 28.2 përqind e tyre kanë rezultuar me të hyra të barabarta me ato të huamarrësit. Shumica e këtyre rasteve me të hyra të barabarta, 56.3 përqind, kanë deklaruar vetëm një të punësuar në ekonominë familjare përkatëse, që nënkupton që ngarkesa me borxh e huamarrësit reflekton njëkohësisht ngarkesën me borxh të familjes. Për 24.1 përqind të observimeve me të hyra të njëjta të individit dhe ekonomisë familjare, mungojnë të dhënat për numrin e të punësuarve. Ndërsa, 19.6 përqind kanë deklaruar më shumë se një të punësuar, por të hyrat e tyre nuk janë reflektuar në buxhetin mujor familjar (Tabela 12).

**Grafik 64. Ngarkesa me borxh e huamarrësit para dhe pas COVID-19 (për klientët e njëjtë për të cilët posedohet informacioni për periudhën para dhe pas shpërthimit të pandemisë)**



Burimi: BQK.

<sup>25</sup> Informacioni për këstet e ristrukturuara pas shpërthimit të pandemisë COVID-19 mund të mos jetë i plotë. Institucionet financiare kanë dërguar informacionet e kësteve të ristrukturuara për kreditë që huamarrësit kishin në institucionet e tyre, por informatat për kreditë e tjera të huamarrësve janë marrë nga RKK, ku edhe mund të mos jenë azhurnuar dhe reflektuar ndryshimet në këste si pasojë e ristrukturimit.

<sup>26</sup> Koha e regjistrimit të të hyrave para pandemisë nuk është konsistent me ndërmjet institucioneve financiare. Përderisa disa prej tyre kanë raportuar të dhënat në muajin e fundit para shpërthimit të pandemisë, të tjerat kanë raportuar të hyrat e huamarrësve të datës së dhënies/aprovimit të kredisë. Gjithashtu, të dhënat pas pandemisë nuk janë të plota (ka mungesa) dhe në shumë raste janë mbledhur në formë të anketimit, që krijon hapësirë për subjektivitetin.


**Tabela 12. Observimet me të hyra të njëjta të huamarrësit dhe ekonominë familjare përkatëse, sipas numrit të anëtarëve të punësuar**

Numri i të punësuarve në ekonominë familjare	Numri i observimeve me të hyra të njëjta për huamarrësin dhe ekonominë familjare	Observimet me të hyra të njëjta për huamarrësin dhe ekonominë familjare (në % ndaj totalit të këtyre observimeve)
1	278	56.3%
2	66	13.4%
3	17	3.4%
4	4	0.8%
5	5	1.0%
6	1	0.2%
7	4	0.8%
Mungojnë	119	24.1%
Gjithsej	494	100.0%


Burimi: BQK.

Sipas indeksit kryesor të ngarkesës që përfshinë vetëm huatë, 11.6 përqind e ekonomive familjare janë të mbingarkuara. Në rrezik për mbi-ngarkesë janë 8.2 përqind e ekonomive familjare, ndërsa 2.0 përqind janë në fazë kritike. Pjesëmarrja e ekonomive familjare jo-solvente, që kanë të hyrat më të ulëta se borxhet, rezultoi të jetë 1.4 përqind (Grafik 65).


Sikurse në rastin e ngarkesës së huamarrësve individual, pjesëmarrja e ekonomive familjare të mbingarkuara është theksueshëm më e lartë kur janë të përfshira të gjitha produktet kreditore (Grafik 65a dhe 65b), por për arsyet tashmë të elaboruara më sipër, do të referohemi vetëm në ngarkesën me borxh për huatë.

**Grafik 65. Shpërndarja e ekonomive familjare sipas indeksit kryesor të ngarkesës**

Burimi: BQK.

**Grafik 65a. Shpërndarja e ekonomive familjare sipas indeksit të ngarkesës për hua dhe mbitërheqje**


Burimi: BQK.

**Grafik 65b. Shpërndarja e ekonomive familjare sipas indeksit të ngarkesës për të gjitha produktet kreditore (hua, mbitërheqje dhe kreditkartela)**

Burimi: BQK.


Ekonomitë familjare të huamarrësve me disa kredi aktive, si dhe të lëshuara prej disa institucioneve të ndryshme, kishin probabilitet dhe nivel më të lartë të mbingarkesës (Grafik 66).

Grafik 66. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas numrit të kontratave (huave) dhe institucioneve kredidhënëse



Burimi: BQK.

Grafik 67. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas numrit të kontratave kreditore




Burimi: BQK.

Problemet me mbingarkesë shpeshtoheshin me rritjen e numrit të kontratave kreditore, me ç’rast ekonomitë familjare të huamarrësve me më shumë se tri kontrata kreditore aktive kishin më së shumti raste të mbingarkesës me borxh (Grafik 67).


Pjesëmarrja e ekonomive familjare të mbingarkuara si dhe niveli i mbingarkesës me borxh ishte më i lartë te ekonomitë familjare të huamarrësve me kontrata kreditore aktive në sektorin bankar dhe mikrofinanciar njëkohësisht. Analizuar ndaras sipas sektorëve, ekonomitë familjare të huamarrësve me kontrata kreditore vetëm në sektorin bankar kishin tendencë më të lartë të mbingarkesës, në krahasim me ata të sektorit mikrofinanciar (Grafik 68).

Grafik 68. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas llojit të institucionit me të cilin janë kontraktuar kreditë



Burimi: BQK.


Grafik 69. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas klasifikimit kreditor



Burimi: BQK.


Niveli i ngarkesës me borxh rezulton i ndërlidhur me performancën e pagesës. Ekonomitë familjare të huamarrësve me vonesa në pagesën e kësteve kreditore kishin dyfish më shumë tendencë të mbingarkesës. Gjithashtu, rastet e jo-solvensës ishin mjaft më të larta në grupin e ekonomive familjare të huamarrësve me vonesa, përkatësisht në 4.1 përqind të rasteve krahasuar me 1.1 përqind të ekonomive familjare të huamarrësve pa vonesa (Grafik 69).

Grafik 70. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas numrit të familjeve të punësuar



Burimi: BQK.

Grafik 71. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas të hyrave mujore familjare




Burimi: BQK.

Përderisa ngarkesa me borxh e huamarrësit individual nuk kishte dallime të theksuara sipas shumicës së karakteristikave socio-demografike, disa nga këto dallime theksohen kur konsiderohet ngarkesa e gjithsej ekonomisë familjare. Niveli i ngarkesës me borxh ishte më i lartë te ekonomitë familjare ku huamarrësit ishin të ndarë, pasuar nga ekonomitë familjare ku huamarrësi ishte i martuar (Grafik A2, Shtojca 3). Ky rezultat ndikohet nga mesatarja më e lartë e borxhit mujor të huamarrësve të ndarë përkundër të hyrave më të larta. Ndërsa huamarrësit e martuar rezultojnë më të mbingarkuar në raport me ata të pamartuar, për shkak të kështit më të lartë përkundër të hyrave të ngjashme.


Niveli i ngarkesës me borxh të ekonomive familjare ka dallime edhe sipas grup moshës së huamarrësit, me ç'rast grup moshë më e mbingarkuar rezulton ajo mbi 60 vite pasuar nga grup moshë 41-50 vite (Grafik A3, Shtojca 3).

Grafik 72. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas statusit të kolateralizimit të huave



Burimi: BQK.

Grafik 73. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas statusit të ristrukturimit të huave



Burimi: BQK.

Dallime të rëndësishme në nivelin e ngarkesës së ekonomive familjare kishte edhe sipas rajoneve, ku rajoni më i mbingarkuar rezulton rajoni i Mitrovicës (Grafik A4, Shtojca 3).

Sipas profesioneve të huamarrësve, dallimet janë të ngjashme me rastin e ngarkesës së huamarrësve individual, ku ekonomitë familjare të pensionistëve, punëtorëve të zyrave dhe asistentët janë më të mbingarkuarit (Grafik A5, Shtojca 3).


Pjesëmarrja e ekonomive familjare të mbingarkuara zvogëlohej me rritjen e numrit të punësuarve në familje. Përkatësisht, ekonomitë familjare me një të punësuar kishin nivelin më të lartë të ngarkesës, dhe shkalla e ngarkesës në përgjithësi zvogëlohej me rritjen e numrit të anëtarëve të punësuar (Grafik 70).

Gjithashtu, pjesëmarrja e ekonomive familjare të mbingarkuara zvogëlohej me rritjen e nivelit të së ardhurave (Grafik 71). Megjithatë, për dallim nga huamarrësit individual, te ekonomitë familjare mesatarja dhe mediana e të hyrave zvogëlohet në mënyrë progresive me rritjen e nivelit të ngarkesës.

Por, mesatarja e vlerës së këstit mujor, shumës së aprovuar dhe shumës së mbetur borxh të huave, njëjtë si te individët, është më e lartë në nivelet më të larta të mbingarkesës (Tabela 13).

Ngarkesa me borxh ishte shumë e shprehur te ekonomitë familjare të huamarrësve të kolateralizuar. Vetëm 2.8 përqind e ekonomive familjare me hua të pakolateralizuara ishin të mbingarkuar, dhe atë asnjë rast jo-solvente. Ndërsa 14.2 përqind e ekonomive familjare me kredi të kolateralizuara ishin të mbingarkuar (Grafik 72). Gjithashtu, pjesëmarrja e ekonomive familjare të mbingarkuara ishte më e lartë në grupin që kishin ristrukturuar kreditë (Grafik 73).

**Grafik 74. Niveli i ngarkesës së ekonomive familjare sipas historisë kreditore të huamarrësit**



Burimi: BQK.


**Tabela 13. Të hyrat mujore , kësti mujor, vlera e aprovuar e kontratave aktive kreditore, dhe vlera e mbetur (në euro), sipas shkallës së ngarkesës së ekonomive familjare**

Nivelet e ngarkesës	Mesatarja e të hyrave mujore të ekonomisë familjare	Mesatarja e vlerës së këstit mujor të huave	Mesatarja e vlerës së aprovuar të huave aktive	Mesatarja e vlerës së mbetur të huave aktive
Të pa ngarkuar	1,094.8	225.6	10,698.7	7,242.2
Në rrezik	909.7	550.3	33,341.8	21,831.8
Në fazë kritike	638.4	545.8	32,380.6	25,657.7
Josolvent	681.4	1,499.1	40,272.2	30,183.4

Burimi: BQK.

Në rastin e ngarkesës së individit, përkundër që në përgjithësi mbingarkesa ishte më e lartë për huamarrësit me histori kreditore, rastet e jo solvencës ishin më të shpeshta tek grupi i huamarrësve të rinj. Ndërsa në rastin e ekonomive familjare, mbingarkesa si dhe niveli i jo solvencës rezultojnë më të larta për grupin e ekonomive familjare ku huamarrësi kishte histori kreditore të më hershme (Grafik 74). Ngarkesa me borxh e ekonomive familjare rezulton më

**Grafik 75. Ngarkesa me borxh e ekonomive familjare para dhe pas pandemisë COVID-19 (për klientët e njëjtë për të cilët posedohet informacioni për periudhën para dhe pas shpërthimit të pandemisë)**



Burimi: BQK.




e lartë në periudhën pas shfaqjes së pandemisë COVID-19. Indeksi i ngarkesës është më i lartë mesatarisht për nga 2 pikë përqindje për secilën prej kategorive të ngarkesës.

Sidoqoftë, ngarkesa pas pandemisë mund të mos reflektoj të gjitha ndryshimet në kështet kreditore, përkatësisht ristrukturimet, për shkak të mungesës së informacionit të plotë mbi kështet e ristrukturuara (Grafik 75).<sup>27</sup>

#### 4.4.2 Indeksi neto i ngarkesës me borxh


Sipas indeksit neto të ngarkesës me borxh të ekonomive familjare<sup>28</sup>, niveli i mos-aftësisë paguese të borxhit rezulton i lartë. Përkatësisht 13.7 përqind e ekonomive familjare rezultojnë jo-solvente - vlerë të borxhit më të lartë se të hyrat neto nga shpenzimet e rregullta mujore.

Grafik 76. Shpërndarja e ekonomive familjare sipas indeksit neto të ngarkesës me borxh



Burimi: BQK.

Grafik 77. Indeksi neto i ngarkesës me borxh të ekonomive familjare para dhe pas shpërthimit të pandemisë COVID-19 (për klientët e njëjtë për të cilët posedohet informacioni për periudhën para dhe pas shpërthimit të pandemisë)



Burimi: BQK.

Në 1.9 përqind të rasteve, shpenzimet mujore të rregullta janë raportuar më të larta se të hyrat bruto të ekonomisë familjare. Pjesëmarrja e huamarrësve të pa-ngarkuar (shuma e kësteve më e ulët se 70 përqind e të hyrave neto) rezulton 70.1 përqind (Grafik 76). Ngjashëm si në rastin e indeksit kryesor me të hyra bruto, edhe sipas indeksit neto, niveli i ngarkesës rritet pas shpërthimit të pandemisë COVID-19 (për grupin e njëjtë të ekonomive familjare për të cilët posedojmë të dhëna para dhe pas pandemisë). Pjesëmarrja e ekonomive familjare me nivel borxhi që tejkalon të hyrat neto rritet në 17.7 përqind, krahasuar me 13.2 përqind para pandemisë (Grafik 77).

Rezultatet e indeksit neto të ngarkesës besohet që në masë të madhe ndikohen nga kualiteti i të dhënave, përkatësisht deklaratimet të shpenzimeve, por edhe të hyrave të ekonomive familjare, për të cilat nuk posedojmë mekanizma të besueshëm për t'i vërtetuar.

#### 4.4.3 Ngarkesa me borxh sipas anketës me ekonomi familjare


Rezultatet e anketës me ekonomi familjare sugjerojnë që 60.3 përqind e ekonomive familjare nuk posedojnë kredi aktive. Mbingarkesa me borxh, përkatësisht shfrytëzimi i më shumë se 50 përqind të hyrave familjare në pagesën e kësteve kreditore, ishte prezent në vetëm 1.9 përqind të rasteve. Ndërsa, 23.3 përqind shfrytëzojnë më pak se 25 përqind të hyrave familjare në servisimin e borxhit. Pjesëmarrja e ekonomive familjare që shfrytëzojnë 20-50 përqind të hyrave në pagesën e kësteve

<sup>27</sup> Kështet e ristrukturuara si pasojë e COVID-19 janë pranuar nga Institucionet Financiare për kreditë aktive të klientëve të tyre (klientëve të përzgjedhur si mostër për institucionin përkatës). Mirëpo, për llogaritjen e borxhit të përgjithshëm të klientit, përkatësisht ekonomisë familjare, janë marrë (mbledhur) të gjitha këstet e huave aktive që kanë figuruar në RKK. Andaj, ristrukturimet tjera që huamarrësit mund të kenë pasur në institucione tjera financiare mund të mos jenë reflektuar në RKK.

<sup>28</sup> Indeksi neto i ngarkesës së ekonomisë familjare paraqet raportin e shumës së kësteve mujore të huamarrësit ndaj të hyrave mujore neto të ekonomisë familjare (të hyrat mujore bruto të zbritura për shpenzimet e rregullta mujore të jetesës së ekonomive familjare, duke mos përfshirë kështet kreditore).


kreditore ishte 9.8 përqind. Nga gjithsej të anketuarit, 4.7 përqind nuk kanë dhënë përgjigje (Grafik 78).

Grafik 78. Raporti i kësteve kreditore ndaj të hyrave familjare



Burimi: BQK.


Grafik 79. Raporti i kësteve kreditore ndaj të hyrave familjare sipas vendbanimit



Burimi: BQK.

Pjesëmarrja e ekonomive familjare që nuk kishin fare kredi ishte më e lartë në vendet rurale, por rastet e mbingarkesës ishin gjithashtu më të shpeshta (Grafik 79). Pjesëmarrja e huamarrësve që nuk kanë kredi ishte më e larta në grupin me të hyrat më të ulëta. Ndërsa, niveli i ngarkesës ishte më i lartë në grupin me të hyra familjare mujore prej 151-300 euro (Grafik 80).


Grafik 80. Raporti i kësteve kreditore ndaj të hyrave familjare sipas nivelit të të hyrave familjare



Burimi: BQK.


Në kuadër të ekonomive familjare që kishin kredi aktive, 4.8 përqind e tyre ishin të mbingarkuara. Pjesëmarrja e ekonomive familjare që shfrytëzonin nën 25 përqind të hyrave familjare në servisimin e borxhit ishte 58.7 përqind, ndërsa e atyre që shfrytëzojnë 20-50 përqind të hyrave në pagesën e kësteve kreditore ishte 24.8 përqind. Përqindje e lartë e ekonomive familjare me kredi aktive, 11.7 përqind, nuk kanë dhënë përgjigje sa i përket raportit të kështit ndaj të hyrave (Grafik 81).

Grafik 81. Raporti i kështjave kreditore ndaj të hyrave familjare (vetë për mostrën e ekonomive që posedojnë kredi)



Burimi: BQK.


Grafik 82. Ndikimi i krizës pandemike COVID-19 në të ardhurat familjare



Burimi: BQK.


Ekonomitë familjare janë pyetur gjithashtu për efektin e mundshëm të shpërthimit të pandemisë COVID-19 në nivelin e të ardhurave të familjes. Një e treta, përkatësisht 35.6 përqind, janë deklaruar se të hyrat e familjes nuk kanë ndryshuar. Në anën tjetër, pjesëmarrje pak më e ulët - 31.1 përqind - kanë deklaruar se të hyrat e familjes së tyre janë zvogëluar.

Grafik 83. Pritjet për të ardhurat familjare në 3 muajt e ardhshëm



Burimi: BQK.

Grafik 84. Shpeshtësia e vonesave më shumë se dy muajt në pagesën e shpenzimeve komunale




Burimi: BQK.

Pjesa tjetër prej 27.8 përqind kanë thënë që kanë pasur rënie të përkohshme në të hyra të cilat janë rikthyer në gjendjen paraprake, ndërsa 5.5 përqind kanë deklaruar se të hyrat familjare janë rritur (Grafik 82).

Për më tepër, në pyetjen për pritjet për nivelin e të hyrave të tyre në tre muajt e ardhshëm, 65.1 përqind kanë deklaruar se nuk presin ndryshime. Pjesa tjetër prej 28.5 përqind kanë thënë se presin rritje në të hyrat familjare, ndërsa vetëm 6.4 përqind kanë thënë se presin rënie (Grafik 83).


Sa i përket aspektit të vonesave në pagesën e obligimeve të rregullta mujore për shpenzime komunale (uji, energjia elektrike, mbeturinat, tatimi në pronë), rezultatet e anketës sugjerojnë që 9 përqind e ekonomive familjare shpeshherë kanë vonesa më të gjata se 2 muajt në pagesën e këtyre obligimeve.

Grafik 85. Shpeshësia e vonesave më shumë se 2 muaj në pagesën e shpenzimeve komunale sipas vendbanimit të ekonomisë familjare



Burimi: BQK.

Grafik 86. Shpeshësia e vonesave më shumë se 2 muaj në pagesën e shpenzimeve komunale sipas të hyrave mujore të ekonomisë familjare



Burimi: BQK.

Përqindje e lartë, 45.7 përqind, kanë deklaruar se vonohen ndonjëherë, ndërsa 28.5 përqind kanë thënë se rrallëherë kanë vonesa të tilla. Pjesa e mbetur prej 16.8 përqind janë deklaruar që janë pagues të rregullt, përkatësisht asnjëherë nuk vonohen më shumë se 2 muaj në pagesën e obligimeve të tilla (Grafik 84). Në aspekt të vendbanimit, ekonomitë familjare në vende rurale kishin pjesëmarrje më të lartë të vonesave të shpeshta (Grafik 85). Sa më të ulëta që ishin të hyrat e ekonomisë familjare, pjesëmarrja e vonesave të shpeshta ishte më e lartë (Grafik 86).

## 5. Përfundim

Kreditimi në Kosovë është rritur me ritëm të përshpejtuar gjatë viteve të fundit, rritje mesatare vjetore prej 10 përqind për bankat në pesë vitet para shpërthimit të pandemisë COVID-19 dhe 23 përqind për institucionet mikrofinanciare. Rritja e ndërmjetësimit financiar dhe zhvillimet e vazhdueshme në tregun e kredisë janë mundësuar nga kushtet e favorshme makroekonomike, mjetet e bollshme të financimit (likuiditetit të favorshëm) dhe rritja e konkurrencës në sektorin financiar. Megjithatë, rritja dyshifrore e kredisë, veçanërisht kreditimi për individët, ka ngritur edhe çështjen e problemit të mbingarkesës së mundshme me borxh të huamarrësve. Mbingarkesa me borxh e huamarrësve, përveç rrezikut të drejtpërdrejtë që paraqet për stabilitetin e sektorit financiar, sjell edhe pasoja sociale dhe psikologjike për klientët e prekur dhe shoqërinë në tërësi. Për më tepër, në rrethanat e ballafaqimit me sfidat e pandemisë COVID-19 në Kosovë, roli i kreditimit si mekanizëm për mbështetjen e rimëkëmbjes ekonomike u rrit tutje. Sidoqoftë, rritja e shpejtë e kreditimit edhe në këtë fazë mund të shtoj tutje ngarkesën me borxh të huamarrësve, me pasoja të mundshme në periudhën afatmesme.

Në këtë studim, është tentuar të matet gjendja e ngarkesës me borxh e huamarrësve dhe ekonomive të tyre familjare, si dhe efektet e mundshme të pandemisë COVID-19 në gjendjen financiare të huamarrësve/ekonomive familjare. Ngarkesa me borxh e huamarrësve nuk ka definicion dhe mënyrë standarde të vlerësimit, andaj në këtë studim janë përdorur kombinim indikatorësh për të vlerësuar aspekte të ndryshme të ngarkesës, në mënyrë që të arrihet te një pasqyrë më reale e problematikës. Indikator i kyç është konsideruar të jetë indeksi i ngarkesës me borxh, i cili është kalkuluar si raport i shumës së borxhit për pagesë mujore (të gjitha kësteve mujore të huave) të huamarrësit ndaj të hyrave mujore. Indikatorë alternativ të ngarkesës janë cilësuar vonesat mbi 2 muaj në pagesën e obligimeve kreditore, posedimi i më shumë se katër kontratave kreditore, si dhe indeksi i ngarkesës me të ardhurat neto. Shtesë ndaj studimit me të dhëna nga institucionet financiare kredidhënëse në Kosovë dhe Regjistri i Kredive të Kosovës, është porositur realizimi i një anketimi të shkurtër me ekonomi familjare, për vlerësim alternativ të gjendjes së borxhit.

Gjetjet e studimit sugjerojnë se pjesëmarrja e ekonomive familjare të mbingarkuara me borxh<sup>29</sup> shtrihet në intervalin ndërmjet 27.4 përqind, kur merren për bazë vetëm të hyrat e huamarrësit, dhe 11.7 përqind kur merren për bazë të hyrat e gjithë njësisë familjare. Vlerësimi i nivelit të ngarkesës bazuar vetëm në të hyrat e huamarrësit mund të reflektoj mbivlerësim të gjendjes së ngarkesës, për shkak të mos përfshirjes së të hyrave të bashkë-huamarrësve. Në anën tjetër, në vlerësimin e nivelit të ngarkesës me të hyra të ekonomisë familjare, për shkak të mungesës së informacionit për borxhin e mundshëm të huave të anëtarëve tjerë të familjes, mund të kemi pasqyrë të nënvlerësuar të nivelit të ngarkesës. Prandaj, për arsytet e më sipërme të ndërlidhura me mungesën e të dhënave por edhe kualitetin e të dhënave të pranuar përmes anketimit, nuk mund të sugjerohet për nivel specifik të mbingarkesës, por sugjerohet që shkalla e ekonomive familjare të mbingarkuara me borxh të huave të shtrihet në intervalin ndërmjet rezultateve të indeksit të ngarkesës së huamarrësit dhe indeksit të ngarkesës së ekonomisë familjare. Pjesëmarrja e huamarrësve në rrezik për mbingarkesë - kësti mujor i huasë përbën 50 deri në 75 përqind së të hyrave mujore - sugjerohet të jetë në intervalin 21.8 përqind (vetëm me të hyra të huamarrësit) dhe 8.2 përqind (të hyrat e ekonomive familjare). Në fazën kritike - me raport të borxhit ndaj të hyrave prej 75-100 përqind - janë 3.8 përqind (vetëm të hyrat e huamarrësve), respektivisht 2.0 përqind (të hyrat e ekonomive familjare). Rastet kur shpenzimet e kësteve të

<sup>29</sup> Shuma e kësteve mujore për huatë tejkalon 50 përqind të të hyrave mujore.

huamarrësit tejkalojnë plotësisht të hyrat mujore bruto duke kaluar në gjendje jo-solvente, paraqiten në 1.8 përqind të mostrës së huamarrësve dhe 1.4 përqind të ekonomive familjare.

Por, rezultatet e anketës me ekonomi familjare të realizuar në mostër të ndryshme të ekonomive familjare japin nivel më të ulët të ngarkesës së ekonomive familjare. Nga ekonomitë familjare të anketuara, 60.3 përqind kanë deklaruar se nuk posedojnë fare kredi aktive dhe vetëm 1.9 përqind shpenzojnë më shumë se 50 përqind të të hyrave familjare në pagesën e kësteve kreditore. Pjesëmarrja e ekonomive familjare të mbingarkuara rritet në 4.8 përqind kur konsiderohen vetëm ekonomitë familjare që kishin kredi aktive.

Studimi sugjeron që kriza pandemike COVID-19 ka ndikuar në rritjen e ngarkesës së ekonomive familjare. Indeksi i ngarkesës rezulton më i lartë pas shfaqjes së pandemisë për mesatarisht nga 2 pikë përqindje për secilën prej kategorive të ngarkesës. Efekti i shpërthimit të pandemisë në rënien e të hyrave të ekonomive familjare mbështetet edhe sipas anketës së realizuar me ekonomi familjare, që sugjeron se të hyrat janë zvogëluar tek rreth një e treta e responentëve, përderisa 27.8 përqind e responentëve kanë deklaruar rënie të përkohshme së të hyrave të cilat janë rikthyer në gjendjen paraprake.

Studimi sugjeron që mbingarkesa me borxh asocohet me huamarrje të shumëfishtë dhe performancë më të dobët të pagesës. Tendencat e mbingarkesës ishin më të larta për ekonomitë familjare të huamarrësve me vonesa në pagesën e kësteve kreditore. Po ashtu problemet me performancë të pagesës si dhe me mbingarkesë shpeshtoheshin me huamarrjen e shumëfishtë, posaçërisht në institucione të ndryshme. Nivelet më të larta të mbingarkesës, rastet kritike dhe ato të jo-solventës, ishin në pothuajse 90 përqind të rasteve të shprehura në mesin e huamarrësve të shumëfishtë nga institucione të ndryshme. Analizuar ndaras sipas sektorëve, pjesëmarrja e huamarrësve me vonesa ishte më e lartë në sektorin mikrofinanciar, ndërsa mbingarkesa ishte më e shprehur te huamarrësit e sektorit bankar.

Studimi gjithashtu ka tentuar të masë ndërlidhjet ndërmjet modeleve të huamarrjes, përkatësisht karakteristikave socio-demografike dhe socio-ekonomike me mbingarkesën, respektivisht performancën e pagesës. Për shumë karakteristika socio-demografike nuk kishte dallime të theksueshme (statistikisht të rëndësishme) në tendencat për mbingarkesë apo vonesë në pagesë të kredive. Por, disa karakteristika si profesioni, grup-mosha, dhe niveli i të ardhurave, në mënyrë të qëndrueshme rezultuan të ndërlidhura me mbingarkesën dhe performancën e pagesës. Në kuadër të modeleve të huamarrjes, të rëndësishme rezultuan kolateralizimi, ristrukturimi i kredive, historia kreditore, si dhe rolet si bashkë-huamarrës dhe garantues.

Megjithatë, duhet të ritheksohet se studimi nuk paraqet ndërlidhje me ndikim të këtyre faktorëve në treguesit e ndryshëm të mbingarkesës, por vetëm asocim krahasimor të nivelit të mbingarkesës mes grupeve të huamarrësve sipas karakteristikave socio-demografike, socio-ekonomike dhe specifike kontraktuale (modeleve të huamarrjes).

## 5.1. Kufizimet e Studimit

Rezultatet e studimit janë subjekt i disa kufizimeve në aspekt të kualitetit së të dhënave në dispozicion dhe supozimeve të bëra konform mungesave të hasura. Në interpretimin e rezultateve janë marrë parasysh kufizimet përkatëse, dhe varësisht nga gjykimi i ndikimit të tyre në kualitetin e rezultateve, është përcaktuar rëndësia e interpretimit të treguesve.

Rrjedhimisht, indeks kryesor i ngarkesës është konsideruar indeksi i bazuar vetëm në këste të huave<sup>30</sup> me pagesa të rregullta. Në rast të përfshirjes së të gjitha produkteve kreditore, ngarkesa

<sup>30</sup> Në hua përfshihen: huatë për qëllime të ndryshme, kreditë hipotekare dhe lizingu financiar.

me borxh rezulton më e lartë dhe konsiderohet e mbivlerësuar. Kjo për faktin se në këstin mujor është përfshirë gjithsej borxhi i mbetur në kreditkartelë/mbitërheqje - në mungesë të informacionit për përcaktimin e kësteve mujore – përderisa borxhi i mbetur zakonisht është i strukturuar në këste (kreditkartela) apo paguhet vetëm në maturim të produktit (mbitërheqja).

Interpretimi i rezultateve të ngarkesës me borxh sipas të hyrave të huamarrësit sugjerohet të plotësohet me rezultatet që bazohen në të dhënat e gjithë njësisë familjare, dhe jo të interpretohen në izolim. Kjo për shkak të kufizimeve në të dhëna për të dy treguesit.

Në rastin e huamarrësit, janë disa aspekte të cilësisë së të dhënave që duhet vënë në dukje: mungesa e informacionit për bashkë-huamarrjet dhe mos-konsistenca e mundshme e kohës së raportimit/azhurnimit së të dhënave për huamarrësin. Sa i përket bashkë-huamarrjes, nuk janë të evidentuara rastet kur huaja është bashkë-huamarrje dhe nuk dihet se a janë përfshirë të hyrat e bashkë-huamarrësit në raportimin e të hyrave në RKK. Sa i përket mos-konsistencës, të hyrat e huamarrësit evidentohen nga institucionet financiare në momentin e disbursimit të kredisë, dhe në rast se nuk janë përditësuar përgjatë kohëzgjatjes së kredisë, atëherë nuk reflektojnë ndryshimet eventuale në të ardhura në kohën e dhënies së informacioneve për studim, e që rrjedhimisht është problematikë që ndikon në nën-vlerësimin apo mbi-vlerësimin e ngarkesës me borxh.

Në rastin e ekonomisë familjare, mungon informacioni për borxhin e mundshëm të anëtarëve tjerë të njësisë familjare, që mund të reflektohet në nënvlerësim të mbingarkesës. Për më tepër, institucionet financiare kanë shprehur dyshim mbi kualitetin e të dhënave për ekonominë familjare që kanë pranuar nga klientët, në mungesë të mekanizmave detyrues për raportim të këtyre të dhënave, si dhe mekanizmave për konfirmimin e tyre (për dallim nga rasti me të dhënat/të hyrat e huamarrësve të cilët janë të obliguar t'i dokumentojnë me kontratë në rastin e aplikimit për kredi dhe janë lehtësisht të konfirmueshme përmes gjendjes bankare). Konform dyshimeve të mësipërme, janë hasur kontradikta në të dhënat e raportuara për ekonominë familjare siç është rasti i mospërputhjes së të hyrave familjare dhe numrit së të punësuarve në familje (të hyrat e ekonomisë familjare janë raportuar të njëjta me ato të huamarrësve, përkundër faktit që është raportuar më shumë se një i punësuar në njësinë familjare). Tutje, shpenzimet mujore të jetesës së ekonomisë familjare në 1.9 përqind të rasteve kanë tejkaluar të hyrat mujore bruto të ekonomisë familjare, pavarësisht nivelit së të hyrave, ndaj dhe krijojnë pasiguri në interpretimin e rezultateve të ngarkesës me borxh sipas indeksit neto.

Dilemat e mësipërme lidhur me të dhënat janë reflektuar edhe në vlerësimin e ngarkesës me borxh pas shfaqjes së pandemisë COVID-19. Për shkak të mungesës së informacionit për kohën se kur janë azhurnuar të hyrat si dhe mungesës së kësteve të ristrukturuara, është supozuar se të hyra kanë mbetur të pandryshuara nga koha e disbursimit dhe këstet janë të njëjta. Mirëpo në rastet kur ky supozim nuk qëndron, krahasimi para dhe pas pandemisë COVID-19 mund të mos reflektoj efektin e pandemisë, por të ndryshimeve të mëhershme të gjendjes financiare të huamarrësve.

Studimi është po ashtu i limituar në mundësinë e ndërlidhjes mes indikatorëve të ndryshëm të ngarkesës. Studimi nuk informon mbi ndërlidhjen shkak-pasojë të variablave, por vetëm në interpretimin krahasimor të performancës së pagesës dhe nivelit të ngarkesës mes grupeve të caktuara sipas karakteristikave socio-demografike dhe karakteristikave të kontratave kreditore. Për më tepër, dallimet metodike dhe ato në mostër ndërmjet indeksit të ngarkesës së studimit dhe anketës së ekonomive familjare të porositur nga BQK, megjithëse plotësojnë njëra tjetrën, limitojnë krahasimin ndërmjet tyre.

## 6. Rekomandime

Mbingarkesa me borxh e ekonomive familjare është koncept kompleks dhe shumëdimensional. Faktorë të shumtë ndikues në ngarkesën me borxh dhe ndërlidhja ndërmjet tyre bën që procesi i vlerësimit të jetë sfidues. Rreziku i mbingarkesës së ekonomive familjare duhet të vlerësohet nga shumë aspekte, duke mbledhur, përpunuar dhe analizuar të dhëna nga tregues të shumtë në mënyrë që të kuptohet dhe pasqyrohet fotografia e plotë e tij. Natyra komplekse e problemit, por edhe kufizimet e shumta në të dhëna për njësinë e ekonomisë familjare, theksojnë nevojën për ndërveprim të institucioneve përkatësisht angazhimin e të gjitha palëve relevante në mbledhjen dhe ofrimin e të dhënave cilësore.

Rekomandimet në lidhje me masa të mundshme që mund të ndërmerren nga palët e interesit, të cilat dalin në mënyrë të natyrshme nga gjetjet e studimit, si dhe nga konsultimet e materialeve dhe palëve relevante, janë paraqitur në vijim:

- **Përmirësimi i kuadrit rregullator për ngushtim të hendekut së të dhënave si dhe përmirësim të cilësisë**

Ngarkesa me borxh në nivel të ekonomive familjare është aspekt me interes kombëtar. Andaj, rekomandohet inicim i diskutimit ndërinstytucional për modalitetet e mundshme të sigurimit të informacionit kualitativ për borxhin dhe të hyrat e njësisë së ekonomisë familjare. Për më tepër, rekomandohet diskutim në krijim të databazës kombëtare të performancës së pagesës së shpenzimeve të rregullta komunale (uji, taksat komunale, energjia elektrike) të ekonomive familjare, informacion ky me rëndësi në vlerësimin e rrezikut kreditor dhe rrezikut të mbingarkesës me borxh të ekonomive familjare.

- **Rritja e qasjes së financimit dhe edukimit të vazhdueshëm financiar**

Edukimi financiar konsiderohet si faktor me efektivitet të lartë në parandalimin e mbingarkesës me borxh, ndihmesën e klientëve për të përmirësuar menaxhimin e financave si dhe rritjen e qasjes në financim. Rezultatet e anketës me borxh të ekonomive familjare të porositur nga BQK sugjerojnë për pjesëmarrje të lartë të ekonomive familjare që nuk posedojnë kredi. Andaj, të gjitha palët e interesit duhet të angazhohen në largimin e barrierave për qasje në financim përmes edukimit të vazhdueshëm financiar dhe adaptimit të politikave jo-përrjashtuese.

- **Aplikimi i vazhdueshëm i praktikave të përgjegjshme të kreditimit**

Ndjekja e politikave të përgjegjshme të kreditimit, përkatësisht vlerësimi i përgjegjshëm i kapacitetit ripagues të kredimarrësve përfaqëson mënyrën më të drejtpërdrejtë të parandalimit të problemit të mbingarkesës me borxh. Institucionet financiare rekomandohet të jenë të përgjegjshëm në aplikimin, dokumentimin dhe monitorimin e treguesit të Borxhit ndaj të hyrave (DTI), Servisimit të borxhit ndaj të hyrave (DSTI) dhe Shumës së kredisë ndaj vlerës së kolateralit (LTV), duke respektuar metodologji të standardizuar ndërkombëtarisht të kalkulimit të këtyre indikatorëve në mënyrë që të sigurohet konsistencë dhe krahasueshmëri ndërmjet periudhave dhe institucioneve.

- **Qasje aktive e institucioneve financiare në parandalimin dhe adresimin e mbingarkesës nga huamarrja e shumëfishtë**



Literatura rekomandon që marrja e borxhit për të shlyer/lehtësuar ngarkesën ekzistuese të borxhit nuk është zgjidhje e problemit të mbingarkesës. Rezultatet e studimit sugjerojnë që posedimi i disa kontratave kreditore aktive, si dhe huamarrja e shumëfishtë nga institucione të ndryshme (banka dhe mikrofinanca) ka ndërlidhje me nivelin më të lartë të ngarkesës dhe performancën më të dobët të pagesës. Institucionet kredidhënëse duhet të kenë kujdes të shtuar ndaj vlerësimit të kapacitetit të klientit për kthim gjatë shqyrtimit të aplikacioneve të reja për kredi (përfshirë produkteve si kreditkartelat), për të mundësuar pagesën e borxheve ekzistuese, ngase kjo praktikë, megjithëse në raste të caktuara mund t'i ndihmojë huamarrësit për tejkalimin e problemeve të përkohshme financiare, mund gjithashtu të përkeqësojë gjendjen financiare dhe kapacitetin për kthim të borxhit.

- **Aplikimi i metodave standarde të regjistrimit dhe dokumentimit të informacionit**

Në vlerësimin e të hyrave të huamarrësve nga një institucion, inkurajohet aplikimi i procedurave standarde të paracaktuara. Dokumentimi i të hyrave bruto me kontratë, si dhe aplikimi i një metodologjie standarde të vlerësimit së të hyrave shtesë dhe të hyrave të bashkë-huamarrësve do të ndihmonin në sigurimin e të dhënave më kualitative për krahasueshmëri dhe analizë të gjendjes së ngarkesës me borxh. Gjithashtu, sugjerohet që institucionet kredidhënëse të bëjnë monitorimin e ndryshimeve eventuale në të hyrat e klientëve në baza të rregullta përgjatë kohëzgjatjes së kontratës kreditore dhe këto ndryshime t'i raportojnë në RKK.

- **Angazhimi i vazhdueshëm në përmirësimin e cilësisë së të dhënave**

Institucionet financiare si dhe RKK të angazhohen në vazhdimësi në rritjen e cilësisë së të dhënave dhe zgjerimin eventual në përfshirjen e sa më shumë fushave së të dhënave dhe informacioneve shtesë. Në këtë linjë, rekomandohet klasifikim adekuat i të dhënave dhe kodim i tyre në mënyrë që të mundësohet analizimi i tyre, siç është rasti me fushën e profesioneve të huamarrësve. Gjithashtu, kodimi/klasifikimi të shqyrtohet me kujdes për të reflektuar nevojat reale të shfrytëzimit, si dhe për të evituar shmangien e përcaktimit të informacionit në kodin/klasifikimin përkatës (në fushën e qëllimit të kredisë, ka pjesëmarrje të lartë të mos-specifikimit, përkatësisht klasifikim në 'të tjera').

- **Adaptimi i praktikave të kontrollit të cilësisë së raportimit**

Studimi evidenton shkallë të lartë të mospërputhjes së të dhënave të caktuara ndërmjet dy bazave të të dhënave, përkatësisht RKK-së si dhe informacionit të dërguar nga institucionet financiare. Në një masë, kjo mund të jetë rezultat i problemit të dimensionit kohor (kohë e ndryshme e raportimit), por në masë të madhe sugjerohet të jetë pasojë e gabimeve në raportim. Mospërputhjet më të theksuara rezultuan në rastet e kësteve kreditore, shumës së mbetur borxh, të hyrave të huamarrësit, qëllimit të kredisë, profesionit dhe komunës. Andaj, për evitim të këtyre problemeve, rekomandohen kontrole më të shpeshta apo rigoroze të cilësisë së raportimit.

## 7. Referenca

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Departamenti i Statistikave (2021).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Regjistri i Kredive të Kosovës (2021).

Business Innovation and Skills Department of the United Kingdom Government (2010) *Over-indebtedness in Britain: Second follow-up report*.

D'Alessio, G., & Iezzi, S. (2013), *Household Over-Indebtedness: Definition and Measurement with Italian Data*, Bank of Italy.

European Commission (2008a), *Towards a common operational European definition of overindebtedness*.

European Commission (2010), *Over-indebtedness: New evidence from the EU-SILC special module*, Research note 4/2010.

European Fund for Southeast Europe (2011), *Study on Indebtedness of Microcredit Clients in Kosovo*.

European Fund for Southeast Europe (2012), *Risk of Over-indebtedness of MSE Clients in Kosovo*.

Haas O. J. (2006), *Over-indebtedness in Germany*, Working Paper No. 44, International Labour Organisation: Geneva.

Maloku, K (2015). *Ngarkesa me borxh e klientëve bankar në Kosovë, nr.1*. Banka Qendore e Republikës së Kosovës: Prishtinë.

Sierminska, E. (2014). *Indebtedness of households and the cost of debt by household type and income group. Research note 10/2014*. European Commission: Brussels.

OXERA (2004). *Are UK households over-indebted?*. Commissioned by the Association for Payment Clearing Services, British Bankers Association, Consumer Credit Association & Finance and Leasing Association.

## SHTOJCAT

**Shtojca 1. Të hyrat mujore të huamarrësve, të shpalosura sipas karakteristikave socio-demografike dhe socio-ekonomike**


Karakteristikat socio-demografike të huamarrësit individual	Para Covid-19		Pas Covid-19	
	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana
Burrë	687	531	726	537
Grua	536	470	605	478
E/! pamartuar	590	491	642	500
Martuar	664	530	706	531
Ve ndarë	1,051	629	1,150	629
Urban	695	535	788	570
Rural	576	488	570	481
Prishtinë	726	560	829	600
Mitrovicë	655	500	681	550
Prizren	619	500	658	500
Ferizaj	560	470	574	500
Gjilan	543	500	576	483
Gjakovë	560	474	574	474
Pejë	613	509	609	500
Forcat e armatosura	462	430	566	503
Menaxherët	1,068	616	1,123	650
Profesionistët	745	565	874	600
Teknikët dhe bashkëpunëtorët profesional	662	499	768	563
Punëtorë zyreje dhe asistent	531	420	556	471
Punonjësit e shërbimit dhe shitjes	574	512	573	511
Punëtorët e aftësuar në bujqësi, pylltari dhe peshkatari	704	567	614	524
Punonjësit e zejes dhe profesioneve të ngjashme	580	500	605	500
Operatorët dhe instaluesit në fabrika dhe makina	556	500	552	500
Profesionet elementare	483	400	479	400
Pensioner	321	268	339	310
Shtëpiake	589	434	516	290
Tjera, përfshirë mirëqenien sociale	609	500	624	485
Student	550	476	608	550
< 30 vjet	537	432	570	450
30 - 40 vjet	661	516	733	526
40 - 50 vjet	740	550	789	537
50- 60 vjet	625	520	650	530
> 60 vjet	560	522	592	514
0-5 vite përvojë pune	494.5	425	549	450
6-10 vite	661.4	508	707	504
mbi 10 vite	704.3	563	789	580
Bankë	633	501	725	534
Mikrofinancë	669	520	609	500

## Shtojca 2. Shpenzimet mujore të ekonomive familjare, të shpalosura sipas karakteristikave socio-demografike dhe socio-ekonomike

Përshkrimi	Para Covid-19		Pas Covid-19	
	Mesatarja	Mediana	Mesatarja	Mediana
Burrë	422	325	455	350
Grua	404	300	441	350
E/l pamartuar	413	310	449	350
Martuar	420	320	452	350
Ve ndarë	342	265	411	400
Urban	466	350	508	400
Rural	358	300	376	300
Prishtinë	482	392	537	400
Mitrovicë	364	295	402	300
Prizren	419	300	440	350
Ferizaj	399	350	415	350
Gjilan	345	300	370	350
Gjakovë	355	300	354	300
Pejë	393	300	430	320
1 (vetëm huamarrësi)	311	274	340	300
2 të punësuar	442	365	479	400
3-5 të punësuar	587	486	634	500
mbi 5 të punësuar	536	450	538	450
Bankë	452	350	497	400
Mikrofinancë	333	300	340	300


### Shtojca 3. Grafikët shtesë

Grafik A1. Performanca e pagesës së huamarrësve sipas gjinisë




Burimi: BQK.

Grafik A2. Shpërndarja e ekonomive familjare sipas indeksit të ngarkesës dhe statusit të huamarrësit




Burimi: BQK.

Grafik A3. Shpërndarja e ekonomive familjare sipas indeksit të ngarkesës dhe moshës së huamarrësit




Burimi: BQK.

Grafik A4. Shpërndarja e ekonomive familjare sipas indeksit të ngarkesës sipas rajonit të huamarrësit



Burimi: BQK.

Grafik A5. Ngarkesa me borxh e ekonomive familjare sipas indeksit të ngarkesës për profesionet e huamarrësit



Burimi: BQK.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 222 055; Fax: +381 38 243 763  
Web: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)